

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7434 E enjte 8 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga JORGJI KOTE

Jo më me këto
10 argumente



Dje në "Deutsche Welle"



Nga VOLKER WAGENER

BE-ja do të bëhet vërtet
ballkanike tani!

Strategjia e re e Komisionit Evropian mbi perspektivën e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor me gjuhën e saj fare të qartë do t'i japë një dinamikë të re ...
Vijon në faqen 18

Premtimi është premtim. Prej 15 vjetësh vendeve të Ballkanit Perëndimor iu ofrua pranimi në familjen e BE-së. Por për momentin ky është guxim ...
Vijon në faqen 19



Zhvillimi i zonave rurale, ja si mund të përfiton

Subvencionet për bujqësinë, si do të ndahet fondi 35 milionë lekë

Nga 60 mijë lekë/ha për ullishtat, deri në 20 mln për përpunimin e ullirit. Pikat e grumbullimit i paguajnë fermerit 50% të vlerës së fidanit

Nga ORNELA MANJANI

Mbarështimi i bletarisë, përmirësimi i menaxhimit të peshkimit, nxitja e kultivimit të sipërfaqes së tokës së papunuar dhe mbështetja e diversifikimit të aktiviteteve ekono-mike në zonat rurale janë katër programet që do të mbështesë financiarisht qeveria shqiptare...

Në faqet 8-9

EKZEKUTIMI I DEVI KASMIT, FLET BABAI I TE RIUT QE U AKUZUA SI BASHKEPUNETOR

HALIPAJ: JAVA E FUNDIT E ELTONIT PARA VRASJES

"Ditën që kanë arrestuar tim bir, ka qenë me letrat e spitalit të së ëmës në xhep dhe me 700 lekë të vjetra. Jemi të varfër, s'e ndihmoj dot"



INTERVISTE EKSKLUZIVE

(Në foto) Elton Halipi. Policia në vendin ku u vra Devi Kasmi



Në faqen 7

DEBATET PER ZGJERIM

Fleckenstein: Këtë vit hapen negociatat, për Tahirin vendos gjykata. Çështja çame, joproductive

Në faqet 2-3

PAS 12 VITESH

Izet Haxhia, ish-truproja i Sali Berishës do të ekstradohet në Shqipëri, turqit e miratojnë

Në faqen 11

LUFTA ITALO-GREKE

Paskal Milo: Histeria fashiste nxori shqiptarët në luftë kundër Greqisë, shkuan edhe me pagesë

Në faqet 16-17

ZGJEDHJET NE FSHF

Duka fiton mandatin e pestë e përlotet. Fino: I pavlefshëm, do e çoj në KAS

Në faqet 20-21

MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Si të luftojmë obezitetin me çaj jeshil dhe limon

Në faqen 13

Zv.ministri i Brendshëm: Veting për punonjësit e policisë dhe Gardës

13 mijë policë në test psikologjik, për drogë e alkool

Zbardhet projektligji, kategoritë e gradat që do t'i nënshtrohen kontrollit

Nga DARINA TANUSHI

Rreth 13 mijë punonjës të policisë do të kalojnë vetingun. Qeveria miratoi dje projektligjin "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e



Brendshme dhe Ankesat". Sipas zv.ministrit të Brendshëm, Julian Hodaj, "qëllimi i kësaj nisme është të japë një kontribut në krijimin dhe konsolidimin e institucioneve të forta dhe të besueshme, me profesionistë me ...

Në faqen 5

INTEGRIMI NE BE REAGIMET

Intervista/ Raportuesi për Shqipërinë: Korrupsioni e krimi kërcënojnë integrimin

Enkel Xhangoli

Raportuesi për Shqipëri në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein, ka folur për "Gazetën Shqiptare" një ditë pas prezantimit të Strategjisë së Zgjerimit të Bashkimit Evropian. Eurodeputeti shprehet se Shqipëria ka bërë hapa para për sa i përket integrimit evropian dhe kjo gjë mund të kurorëzohet me hapjen negociatave këtë vit. I pyetur për protestën e opozitës dhe akuzat e saj për korrupsion në drejtim të qeverisë "Rama", Fleckenstein shprehet se protestat janë demokratike dhe për sa kohë ato nuk pengojnë procese ligjore dhe integruese të vendit, nuk ndikojnë në çeljen e negociatave. Gjithashtu, ai shprehet se akuzat e opozitës ndaj kabinetit "Rama" nuk janë ndonjë mesazh i ri, pasi të tilla akuzat ka pasur për një kohë të gjatë. Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian foli edhe për sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Sipas tij, ky sistem është futur në një fazë transformimi dhe me implementimin e reformës në drejtësi, ajo do të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke krijuar struktura të forta për hapjen e negociatave për në BE. Fleckenstein tha se debatet midis fqinjëve nuk janë produktive dhe se duhet të gjenden zgjidhje për çdo shtet që kërkon të bëhet pjesë e BE, ndër të tjera ai shtoi se deri më tani diskutimet mes dy vendeve kanë në filluar dhe do të finalizohen me marrëveshje të përbashkëta frytdhënëse. Në intervistën ekskluzive për "Gazetën Shqiptare", ai u pyet edhe për akuzat për trafik droge ndaj ish-ministrit e Brendshëm, Saimir Tahiri. Ai u shpreh se kjo çështje i takon drejtësisë dhe gjyqtareve për ta vlerësuar, por nuk e ngadalëson hovin e Shqipërisë për hapjen sa më të shpejtë të negociatave. Duke krahasuar me vendet e tjera të rajonit, eurodeputeti tha se tashmë dy shtete të rajonit janë gati për në BE, ndërsa Shqipëria apo vendet e tjera duhet të shikohen se si do të ecin me implementimin e reformave.

Z. Fleckenstein, vetëm dy javë më parë ishte një protestë e opozitës, që akuzoi qeverinë e Ramës për korrupsion. A mendoni se këto protesta i shërbejnë vendit dhe si ndikojnë ato në negociatat me Bashkimin Evropian?
Mendoj se protestat në një vend demokratik janë normale dhe për aq kohë sa ato

Knut Fleckenstein: Këtë vit hapen negociatat, për Tahirin vendos gjykata

"Çështja çame, debatet mes fqinjëve, jo produktive"



Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein

GREQIA

"Besoj se gjuha e ashpër mes dy vendeve nuk i shërben askujt, por mesa di unë, Greqia dhe Shqipëria kanë nisur diskutimet dhe me shumë mundësi do të arrihen marrëveshje frytdhënëse për të dyja palët. Theksoj se çdo vend që aspiron BE nuk duhet të ketë konflikte me shtete të tjera", komentoi Fleckenstein.



Gjatë një seance parlamentare

doni për gjuhën e ashpër të presidentit grek mbi shqiptarët, mendoni se kjo deklaratë po dëmton marrëdhëniet midis dy vendeve?
Besoj se gjuha e ashpër mes dy vendeve nuk i shërben askujt, por mesa di unë, Greqia dhe Shqipëria kanë nisur diskutimet dhe me shumë mundësi do të arrihen marrëveshje frytdhënëse për të dyja palët. Theksoj se çdo vend që aspiron BE nuk duhet të ketë konflikte me shtete të tjera.

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është i akuzuar për trafik ndërkombëtar të drogës, si ka ndikuar në procesin e hapjes së negociatave?
Kjo çështje besoj se i përket drejtësisë për ta vlerësuar, por mund të them që nuk ka ndikuar në negociatat e Shqipërisë për në BE. Kaq mund të komentoj.

Cili është problemi më i madh për Shqipërinë, që pengon bashkimin me shtetet e tjera evropiane?
Besoj se problemi më i madh në Shqipëri, por edhe në shumë vende në rajon, është lufta ndaj korrupsionit dhe krimin. Këta janë faktorët, të cilët mund të kërcënojnë çeljen e negociatave.

Nëse e krahasojmë atë me vendet e tjera të rajonit, ku do të renditet Shqipëria për fazën e hapjes së negociatave?
Dy vendet e rajonit janë shumë afër hapjes së negociatave, por nuk mund të them se ku do të renditet Shqipëria, pasi gjithçka varet se si një vend implementon reformat, duke hedhur hapa të mëdha për në BE. Pra, çdo gjë mund të ndryshojë qoftë edhe për një kohë të shkurtër.

Shefja e misionit të BE-së: Tahiri? Po presim prokurorinë të bëjë progres

Vlahutin: Presim një gjyqësor ku të sundojë ligji dhe jo paraja



DEKLARATA

"Ne mbështesim reformat që do vendi dhe që i kërkohen njerëzit. Ajo për të cilën tani ka nevojë Shqipëria është uniteti i qëllimit. Shqipëria ka nevojë që të gjithë politikanët të bashkohen dhe të zbatojnë plotësisht reformën në drejtësi, të bien dakord për çështjet kyçe me interes kombëtar, që nuk mund të jenë objekt për asnjë mosmarrëveshje", tha Vlahutin.

Samitit të Selanikut, më 2003, që do të vlerësojë të gjitha arritjet në rajon deri tani. Dhe e gjithë kjo do të përcaktojë hapat dhe vendimet e ardhshme. Më lejoni të theksoj që hapja e negociatave të pranimit nuk është një dhuiratë, është një detyrim shtesë dhe shumë punë. Por, hapja e negociatave ankoron vendin

në mënyrë të vendosur në procesin e pakthyeshmë të reformave sistematike", sqaroi shefja e BE-së në Tiranë. Sipas saj, "ajo që pa dyshim është e qartë, është që Shqipëria ka bërë një punë të jashtëzakonshme me miratimin konsensual të amendamenteve kushtetuese për reformën e sistemit të drejtë-

sisë, miratimin e mëvonshëm të ligjeve të shumta lidhur me këtë reformë dhe fillimin e funksionimit të institucioneve të reja, duke filluar me ato që janë përgjegjëse për vettingun". Por, Vlahutin tha se duhet parë progres edhe në çështje të tjera si mjedisi, bujqësia, transporti dhe pronat. Në lidhje me qëndrimet e opozitës, Vlahutin tha: "Puna jonë si diplomatë nuk është që të bëjmë në kurthin e retorikës së politikës së ditës, por të shqyrtojmë faktet e konfirmuara dhe vetëm faktet e konfirmuara". Duke folur për reformën në drejtësi dhe vettingun, Vlahutin shtoi: "Po presim gjithashtu të shohim nëse prokuroria do të bëjë progres të pandërprerë për rastin e ish-ministrit të Brendshëm".

si, ajo do të luftojë ashpër korrupsionin dhe krimin e organizuar në vend, gjithashtu të pastrohet edhe nga gjykatës të korrumpuar. Kjo gjë do të përshpejtojë më tepër bashkimin e Shqipërisë në familjen evropiane. Duhet

thënë që bashkëpunimi midis institucioneve duhet të jetë i ngushtë dhe i drejtë.

Presidenti grek u shpreh disa ditë më parë që shqiptarët duhet të jenë të kujdesshëm kur flasin për çështjen çame. Çfarë men-



Zgjerimi, BE: Të hapen negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë

Debate në Parlamentin Evropian, McAllister: Të plotësohen kushtet

Kukan: PE të ndihmojë për zgjedhjen e krizave politike

Valentina Madani

Bashkimi Evropian pranon që Shqipëria ka bërë progres për hapjen e negociatave, por duke i kujtuar klasës politike se duhet bashkëpunim mes palëve për përmbushjen e reformave integruese. Parlamenti Evropian diskutoi në seancë plenare strategjinë e Komisionit Evropian për zgjerimin e Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit. Raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein, kërkoi hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë këtë vit. Fleckenstein shprehet se Shqipëria ka bërë progres për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, ndërsa mirëpret vendimin final: "Ne e mirëpresim këtë strategji, pasi ajo injektton dinamizëm dhe përmes saj u dërgojmë një sinjal miqve tanë në Ballkan, se ne jemi seriozë. Strategjisë nuk i mungojnë vullneti i mirë dhe fjalët e mira, por aty mungon shpejtësia e avancimit të procesit. Sigurisht që duhen hapur më shumë kapituj me Serbinë dhe Malin e Zi, por ne duam të hapin negociata me Shqipërinë dhe Maqedoninë këtë vit. Shqipëria ka bërë progres, po ashtu edhe Maqedonia dhe ne nuk duhet të impresionohemi nga nacionalistët në Selanik, Shkup apo Bruksel", deklaroi z.Fleckenstein. Reagimi i Knut Fleckenstein vjen pas prezantimit të strategjisë së BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Shefja e Politikës së Jashtme të BE, por edhe zyrtarë të tjerë në tri ditët e fundit kanë vlerësuar avancimin e Shqipërisë, por duke vendosur theksin të reforma në drejtësi. Eurodeputeti Eduard Kukan tha se, "lidhur me mosmarrëveshjet bilaterale, Bashkimi Evropian ka luajtur një rol të rëndësishëm për zgjedhjen e krizave politike në këto vende". Gjatë diskutimit nuk mungoi edhe skepticizmi i evropianëve për zgjerimet e ardhshme të Bashkimit Eu-



Parlamenti Evropian

Parlamenti Evropian diskutoi në seancë plenare strategjinë e Komisionit Evropian për zgjerimin e Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit.

Komisioni i Integritetit kërkon seancë dëgjimore me Bushatin

Komisioni i Integritetit kërkon në seancë dëgjimore me ministrin Ditmir Bushati për të shpallur objektivat që do të ndjekë Shqipëria për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Mazhoranca dhe opozita ishin dakord në këtë pikë, ndërsa deputetja demokratike, Jorida Tabaku, tha se shumica duhet të përfshijë opozitën në proces. Znj. Tabaku u shpreh se qeveria ka për detyrë të përfshijë opozitën në proces, ndaj sipas saj, ministri duhet të informojë komisionin për strategjinë që do të ndiqet. "Ne duhet të fokusohemi tek detyrat dhe prioritetet e vendosura në strategjinë e Zgjerimit. Ka detyra të qarta, ka një mundësi konkrete dhe ashtu siç thotë Strategjia e Zgjerimit, është në dorë të autoriteteve dhe në këtë rast autoriteti është qeveria shqiptare", tha Tabaku. Socialisti Bledar Çuçi ishte dakord me kërkesën e opozitës, ndërsa tha se Komisioni i Integritetit duhet të monitorojë procesin.



'Krimi', Mediu në takimin e senatit amerikan

Në një nga mjediset e Kongresit Amerikan u mbajt një forum mbi sfidat gjeopolitike në Evropën Juglindore. Pjesëmarrësit ku përfshiheshin ligvënës amerikanë, si edhe politikanë të rajonit dhe vendeve evropiano-perëndimore, shprehën shqetësimin rreth përpjekjeve ruse për ndërhyrje në rajon. Takimi u organizua nga "Senat Armed Service committee" Senatori Inhofe dhe deputeti Mediu. Roli i NATO-s dhe SHBA-ve, agresiviteti i Rusisë, marrëdhëniet e Rusisë me Turqinë, investimet kineze dhe perspektiva evropiane ishin temat e diskutuara gjatë takimit. Thëksi gjithashtu u vu tek fakti që stabiliteti i çdo vendi të rajonit lidhet me luftën kundër korrupsionit, kriminit të organizuar, zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Vendosja e këtyre standardeve siguron partneritet me SHBA-të si dhe anëtarësimin në NATO dhe BE.



Vlahutin i dorëzon Strategjinë e Zgjerimit

Kryemadhi: Shpresojmë që të hapen negociatat në qershor

Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin zhvilloi dje një takim me kryetaren e LSI, Monika Kryemadhi në Kryesinë e Kuvendit. Vlahutin i dorëzoi kryetares se LSI-së Strategjinë e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kryetarja e LSI-së, Kryemadhi është shprehur: "Integrimi i Shqipërisë në BE u takon qytetarëve dhe si i tillë, ne shpresojmë që brenda qershorit ne të kemi një vendim pozitiv për çeljen e negociatave". Strategjia e Zgjerimit u prezantua dje, ndërsa u vendos theksi te fakti që Shqipëria duhet të zbatojë reformën në drejtësi që të hapen negociatat me BE në qershor Kurse ish-ministria e Integritetit, Klajda Gjoshja foli në "News 24" për Strategjinë e Zgjerim-



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

it të BE për vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjoshja tha se Shqipëria duhet të ishte pjesë e strategjisë për vitin 2025, por sipas saj, KE do rekomandojë hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ish-ministria ka edhe një apel për qeverinë, teksa tha se hapja e negociatave për anëtarësimin në BE nuk duhet të përdoret si triumf. "Para se të flasim për standarde pozitive, ne duhet të

flasim për problematikat që ekzistojnë. Nuk kemi asnjë raportim për 5 prioritet kryesorë. Për t'u çelur negociatat me BE duhet të zbatohet reforma në drejtësi dhe vettingu. Ligjet e reformës kanë probleme me implementimin. Çështja e kanabisit është një nga plagët e Shqipërisë. Qeveria t'i harrojë negociatat, nëse nuk merr seriozisht plotë-

ropian. "Hyryja e vendeve të Ballkanit në BE do të varet nga situata në secilin vend dhe kushtet duhet të përmbushen të gjitha. Shteti ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe pavarësia e mediave janë në qendër të vëmendjes", tha eurodeputeti David Mc Allister. Kurse eurodeputeti Viktor Bostinaru u shpreh:

"Strategjia është hapi i duhur në drejtimin e duhur. Ne duhet të bëjmë më shumë se vetëm fjalë dhe ajo që nevojitet është që kjo të reflektohet në perspektivat financiare të Bashkimit Evropian. Duhet më shumë iniciativa dhe më shumë investime në Ballkan". Eurodeputeti tjetër, Carles Tannock

tha se, "2025-ta është një perspektivë e mirëpritur, por nuk mund të injorim skepticizmin e qytetarëve në disa shtete anëtare për zgjerimin e ardhshëm të BE-së, kryesisht për çështjet e korrupsionit dhe kriminit të organizuar. Madje, mund të kemi edhe një referendum në Francë për këtë".

QEVERIA REFORMAT

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama paralajmëroi të gjithë zyrtarët që nuk u përgjigjen kërkesave të qytetarëve se do të përballen me përgjegjësitë, largim nga administrata, por deri edhe ligjore. Në fjalën që mbajti në Konferencën Kombëtare për Reformimin e Shërbimeve Administrative, kryeministri Rama foli për reduktimin e dokumenteve që u kërkojnë qytetarëve në institucione të ndryshme. "Ne shkurtojmë 1360 vjet pritje në një vit të vetëm. Eshhtë një vullm i paimagjinueshëm kohe, stresi dhe sigurisht i panevojshëm shpenzimesh mbi dhe nën dorë, prej 1360 vitesh që shkurtohen, që do të thotë se shkurtohet në mënyrë drastike numri i ndërveprimeve mes qytetarit dhe shtetit, mes shtetit dhe sipërmarrjes, duke shkurruar duart e shtetit në jetën dhe në xhepin e qytetarëve dhe të sipërmarrjes", tha Rama. "Eshhtë një reformë antitepsi e mirëfilltë. Një operacion antitepsi në kuadër të objektivit strategjik të këtij mandati, për ta çuar tepsinë për skrap, sepse shumëkush që vazhdon dhe kërkon një punë shteti, nuk e kërkon për t'i shërbyer shtetit, por e kërkon me idenë e rehatisë dhe mundësisë për të zgjatur duart në drejtim të xhepit të qytetarëve dhe sipërmarrjes", u shpreh kryeministri. Sipas Ramës, reforma në drejtësi e vetingu është ilaçi i duhur ashtu si dhe ndëshkimet që do pasojnë janë ilaçi i duhur. Duke folur për rezultatet që merren nga komunikimi i qytetarëve në platformën e bashkëqeverisjes, Rama u tha të pranishmëve dhe publikut: "Mjafton që të marrësh mundimin 3 minuta dhe në vend që të kërkoresh mik, në vend se të japësh lekë, të presësh që zgjidhja të të vijë nga rrugë të vjetra, thjesht e vetëm të besosh që ti e zgjidh vetë problemin tënd, për 3 minuta, duke futur mikun më të madh, Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Duke futur mikun më të lartë, ministrin apo ministrën përkatëse në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, sipas sektorit ku ti po e kërkon të drejtën dhe sot kemi mbi 2500 raste konkrete, siç janë këto 5 raste këtu, që e provojnë këtë". "Ruhuni edhe nga qytetarët e pafuqishëm. Je i vdekur, je i mbaruar, nuk të mban më në karrige asgjë, nuk ka kushëri që të mban më aty. Sot kemi 35 punonjës hipotekash që janë në

Kryeministri: Janë 35 punonjës hipotekash në prokurori, nuk të mbron partia

Rama paralajmëron "parazitët" në shtet: Ruhuni nga qytetarët, jeni të vdekur

"Çdo njeri të jetë një kërcënim për çdo grabitqar"



Kryeministri
Edi Rama

PARALAJMËRIMI

"Duhet të ruhen, sepse mjafton që ai qytetari që të del përpara e që të duket sikur nuk ka pikë fuqije, t'i marrë ato tri minuta kohë dhe nuk të mban dot më në karrige asgjë. Nuk ka parti, nuk ka mundësi, nuk ka kushëri që të mban më aty", tha Rama.



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

Ministri i Financave: Edhe në Tatime merren vërtetimet 'online'

Ahmetaj: Deri në fund të marsit, invalidët e gratë shtatzëna marrin 'online' dokumentet

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj njoftoi dje se invalidët e gratë shtatzëna do të marrin 'online' deri në fund të muajit mars të gjithë dokumentacionin. Gjatë fjalës në Konferencën Kombëtare për Reformimin e Shërbimeve Administrative, Ahmetaj u shpreh: "Dy elementet do t'ju bënin përshtypje, për një leje barrë lindje, një zonjë duhet të shkojë 8 herë në zyrat e fondit të ISSH-së, një invalid breth në 8 sportele fizikisht. Në fund të marsit të gjitha këto dokumente do të jenë 'online' dhe do të jenë detyrim i adminis-



tratës për të plotësuar dokumentacionin dhe në rastin më të keq, të shkojë vetëm një herë dhe në rastin më të mirë të mos shkojë fare". Duke prezantuar shembuj nga institucionet e tij të varësisë,

Ahmetaj tha se shembulli tipik është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku 13 autorizime të domosdoshme të marra në mënyrë të printuar janë përsëritur në vit 600 mijë herë. 600 mijë herë, të cilat presupozonin njerëz, kohë fizike, por edhe kosto. "Ne në tetor të vitit të kaluar kaluam 'online' me alternativë printim. Fillimisht u hoq dorë në një përqindje të vogël nga printimi dhe nga prezantimi në sportelet e Tatimeve. Në momentin që kaluam pa alternativë vetëm 'online', sot në dy muaj janë 144 mijë vërtetime që merren 'online'.

'shqipëriaqeduam.al' kanë denoncuar rastin", u shpreh Rama. Kryeministri tha se për çdo rast "është hetuar se kush ua ka penguar me vite dhe të gjithë ata që e kanë penguar janë larguar nga detyra e janë për hetim. Ta provojnë ata, pse e kanë penguar. E kanë penguar se janë parazitë, apo se janë grabitqarë. Në të dyja rastet,

qofshin grabitqarë, qofshin parazitë, shtetit dhe administratës nuk i duhen. Në rastin kur janë thjesht parazitë, le të vazhdojë të kërkojnë të ndërtojnë jetën e tyre jashtë detyrës të shtetit. Kur janë grabitqarë, le të shkojnë aty ku e kanë vendin. Këtë e provon prokuroria dhe gjykata". Kryeministri paralajmëroi veçanë-

Kreu i grupit të LSI kritikon Ramën: Nuk një ligjin

Vasili: Kryeministër i degraduar, mendon vetëm për shtet-tepsinë

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili e cilësoi dje "të degraduar" kryeministrin Rama. Pas deklarativës të kryeministrit për punonjësit e shtetit, Vasili shkroi në "Facebook": "Kryeministri i degraduar antishtet nje vetëm mikun, jo ligjet. Kryeministri antishtet, i kapur dhe i kriminalizuar e urren që të ndërtojë shtet që funksionon me ligje dhe rregulla. Kryeministri i falimentuar i Rilindjes ka vetëm një gjë në tru: 'shtetin e mikut'. Këtë antishtet e urrejnë shqiptarët. Qytetarët nuk duan të fusin mik as shtetin e falimentuar e të korruptuar të kryeministrit dhe as gjithfarë sekserësh të pacipë. Qytetarët duan thjesht standarde e ligje dhe zgjidhjen e problemeve në bazë të tyre pa nevojën e askujt", u shpreh Vasili. Sipas tij, "Kryeministri i degraduar ka në mendje vetëm shtet-tepsinë private të tij, ku ai dhe ministrat e tij për se vap u zgjidhin ndonjë hall njerëzve, në një kohë që ua kanë për detyrim të madh".



"Presioni mbi parazitët e grabitqarët duhet të vijë nga lart dhe nga poshtë. Presion total. Çdo njeri duhet të jetë një kërcënim për çdo parazit e për çdo grabitqar. Ti thjesht merri të drejtën tënde. Më pas vazhdojmë me punën, për ta çuar përpara drejtësisë. Ai le ta provojë pse s'ta ka dhënë të drejtën", u tha Rama qytetarëve.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 26.02.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shiten e pasurise te paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m², me Nr pasurie 1/154s-1-4, Vol.7, Fq.247 me vliere fillestare ne ankand 24.570 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II per shiten e pasurise te paluajtshme Truall me Nr. pasurie.6/286 dhe sip.242 m², Zona Kadastrale Nr.8513, Vol.24, Fq.102 e ndodhur ne Rr"V.Kuçq", Lagjia 12, Durrës me vliere fillestare ne ankand 67.200 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shiten e pasurise te paluajtshme Ndërtëse me Nr. pasurie.6/56 dhe sip.108.24 m², Zona Kadastrale Nr.8513,vol.31,Fq.121 e ndodhur ne Rr"V.Kuçq",Lagjia 12, Durrës me vliere fillestare ne ankand 1,120 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



Darina Tanushi

Rreth 13 mijë punonjës të policisë do të kalojnë vetingun. Qeveria miratoi dje projektligjin "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat". Sipas zv.ministrit të Brendshëm, Julian Hodaj, "qëllimi i kësaj nisme është të japë një kontribut në krijimin dhe konsolidimin e institucioneve të forta dhe të besueshme, me profesionistë me integritet". Sipas tij, "vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-ve nuk është thjesht largimi i disa individëve nga këto struktura. Padyshim, pastrimi i radhëve është i rëndësishëm në kushtet kur brenda tyre ka elemente të prekur nga krimi, korrupsioni apo të paafët. Gjithësesi, aspekti më i rëndësishëm i kësaj nisme është një tjetër: është promovimi i atyre që janë të ndershëm, të aftë dhe të përkushtuar, është çlirimi i energjive pozitive, sot disi të fjetura, tek pjesa e shëndoshë e këtyre institucioneve". Zv.ministri sqaroi se, "është përzgjedhur një model i përzirur ku gradat e larta vlerësohen nga komisione të pavarura me punonjës të rekrutuar nga jashtë, ndërsa në nivelet e tjera komisionet integrohen me punonjës që e kanë kaluar me sukses vlerësimin". "Janë konsideruar me kujdes të gjitha aspektet organizative dhe financiare, për një proces të paanshëm, cilësor e transparent, të shpejtë në kohë dhe me kosto të përballueshme, duke qenë se flasin për vlerësimin e rreth 13,000 punonjësve", tha Hodaj.

Drafti u hartua me bashkëpunimin e misioneve që asistojnë Policinë e Shtetit, PAMECA dhe ICITAP, të cilat ishin pjesë e grupit të punës, Ministria e Brendshme nuk do të pjesë e procesit e vlerësimit për të garantuar pavarësinë, paanshmërinë dhe besueshmërinë e tij, përkundrazi vetë punonjësve dhe publikut. Ndërsa sipas Hodaj, partnerët ndërkombëtarë do të kenë rol monitorues dhe këshillues përgjatë gjithë procesit, duke nisur që nga përzgjedhja e anëtarëve të komisionit të parë të vetingut dhe duke vazhduar këtë rol gjatë procesit të vlerësimit, me qëllim garantimin e cilësisë, zbatimit të njëjtë të standardeve dhe garantinë të transparencës së vetë këtij procesi.

Zv.ministri i Brendshëm: Veting për punonjësit e policisë e Gardës

Zbardhet projektligji, 13 mijë policë në test psikologjik, për drogë apo alkool

Kategoritë e gradat që do t'i nënshtrohen kontrollit



Zv.ministri i Brendshëm, Julian Hodaj



Faksimile e projektligjit për vetingun e punonjësve të policisë

këtë ligj.
Neni 35
Vlerësimi i rrethanave për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës, Trupat e Vlerësimit mbajnë në konsideratë rrethanat e mëposhtme:
a) Verifikimin e saktë të identitetit në të shkuarën dhe të tashmen për çdo punonjës që i nënshtrohet kontrollit dhe arsyen e ndryshimeve të emrit e mbiemrit apo generaliteteve të tjera.
b) Të dhënat për vendbanimin aktual dhe të mëparshëm, brenda dhe jashtë vendit.
c) Rastet e ndryshimeve ose marrjes së shtetësisë të tjera.

d) Ndalimi për hyrje në vendet e Bashkimit Evropian ose të NATO-s.
e) Kërkesa për azil në ndonjë shtet.

f) Verifikimin e procedimeve penale ndaj punonjësit, brenda dhe jashtë vendit.

g) Verifikimin e procedimeve administrative apo vendimeve përkatëse, brenda dhe jashtë vendit.
h) Dëblimin nga shtete të tjera, për shkelje të rregullave të hyrjes apo qëndrimit.
i) Testimin për përdorim të lëndës narkotike.

j) Varësinë nga alkooli apo nga lojërat e fatit.
k) Verifikimin nëse ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit mbi të drejtën e informimit me dokumentet e Ish-Shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

2. Punonjësi i nënshtrohet një testi psikologjik të personalitetit, si dhe mund t'i nënshtrohet, me vendim të trupës së vlerësimit përkatëse dhe me pëlqimin e tij, testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale. Refuzimi i kryerjes së testeve vlerësohet së bashku me rrethanat e tjera.

PROJEKTILIGJI

Në projektin që do diskutohet në Kuvend përcaktohet:

Neni 3 Vlerësimi kalimtar

1. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do të përfundojë brenda një periudhe prej 24 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve ka për objekt:

- a) vlerësimin e pasurisë
- b) kontrollin e figurës
- c) vlerësimin e aftësive profesionale.

3. Procesi i vlerësimit kalimtar bazohet në parimin e ligshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

4. E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit mund të kufizohet nga organi përkatës i vlerësimit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë e të rëndë për administrimin e procesit të vlerësimit kalimtar.

Neni 5

Fushat e ushtrimit të veprimtarisë së organeve të vlerësimit kalimtar

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit vlerëson punonjësit në pozicionet ose me gradat e mëposhtme:

a) Drejtor dhe zëvendës-drejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor e zëvendës-drejtor vendor dhe shefkomisariatit, në Policinë e Shtetit.

b) Komandant e zëvendës-komandant si dhe çdo officer me gradë major, nënkolonel dhe kolonel në Gardën e Republikës.

c) Drejtor dhe zëvendës-drejtor i përgjithshëm si dhe drejtor e shef sektori në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

2. Komisioni Qendror i Vlerësimit vlerëson:

a) Punonjësit e policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në strukturat e veçanta, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, punonjësit e Akademisë së Sigurisë dhe të Institutit të Policisë Shkencore.

b) Punonjësit e Gardës së Republikës me gradë nëntoger, toger, nënkapiten, kapiten.

c) Punonjësit e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni.

3. Komisioni Vendor i Vlerësimit vlerëson punonjësit e Policisë së Shtetit pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Gardës së Republikës, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij neni.

4. Punonjësit e njësive, repartëve, strukturave, përbërja e të cilave apo tipologjia e punës nuk mund të jenë publike vlerësohen nga trupa të posaçme vlerësimi, që krijohen në Komisionin Qendror dhe Vendor të Vlerësimit, me propozimin e titullarit të institucionit përkatës.

5. Vlerësimi kalimtar, sipas pikës 1 të këtij neni i nënshtrohen me kërkesë të tyre edhe ish-punonjësit e këtyre institucioneve, të cilët plotësojnë këto kritere:

a) Nuk kanë mbushur moshën për pension të parakohshëm, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

b) Nuk janë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

c) Nuk janë përjashtuar, apo në rastet kur masa disiplinore e përjashtimit e marrë ndaj tyre është shfuqizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Kërkesa dhe formularët e deklarimit dorëzohen nga ish-punonjësit pranë njësive së burimeve njerëzore të institucionit përkatës, sipas afateve të përcaktuara në

CEREMONIA

I jepet lamtumira drejtueses së LSI-së, Luzhiana Abazi.

Meta: Mbetet model

Mes lotëve, por edhe duartrokitjeve është përcjellë për në banesën e fundit mjekja dhe anëtarja e kryesisë së LSI-së, Luzhiana Abazi. Të afërm, miq, kolegë dhe përfaqësues të lartë të shtetit e politikës kanë bërë homazhe duke i dhënë lamtumirën e fundit. Presidenti Meta, që e ka pasur bashkudhëtarë në betejat politike ka shprehur ngushëllime duke thënë se e ndjera Abazi ka qenë model i femrës guximtare. "Do mbetet një model, detyrë e vazhve të guximshme, të cilat shikojnë përtej botës së tyre dhe të familjes së tyre, të cilat jetojnë me shqetësimet e shqetësisë", u shpreh Presidenti Meta. I pranishëm në homazhe ishte edhe kreu i PD-së, Lulzim Basha. Luzhiana Abazi, e cila së fundmi ka qenë kryetare e njësisë nr.6 në Tiranë, ka qenë mjaft aktive në skenën politike shqiptare, duke qenë një nga themelueset e LSI-së.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 02.03.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1000 m², numër pasurie 234/33, Zona Kadastrale 3339, Volumni 11, Faqe 208 e ndodhur në Vrinë. Durrës në pronësi të Z.Ardian Rexhep Kola me vlerë fillestare në ankand 1,764,000 LEKE.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 354 2 31 888. email enuar.merko@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESË GJYQËSORË PRIVATE
SHOQËRIA PËRMBARIMORË "EXECUTORËS LITUM" (EXC LIT) sh.p.k
Shoqëria Përbarimorë "Executores Litum" sh.p.k
do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme:
Njësi me nr. Pasurie 6/121-N12, vol 22, fq.28, e regjistruar në ZVRPP Tiranë ZK 8160, me sipërfaqe 37 m², në pronësi të Albert Sokol Elezi
Cënimi ims të zhvillohet në fillim ankandit është në vlerën 20,720 Euro
Ankand do të zhvillohet në datë 05.03.2018 ora 16:00, në zyrën përbarimorë "Executores Litum" sh.p.k, me adresë Biv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë.

Njoftim për shitje me ankand
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e debitorit Shoqëria "Extra Cleaner" sh.p.k dhe Hipotekuese A Milia. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:
- Apartamenti me numur pasurie 1/126+1 - 4 Zone Kadastrale 8170 Volumni 1, Faqe 154, me sipërfaqe 75.1 m², në adresën Rr Q Stafa pall 8, shk 1, kati dyte, Ap 4 Tiranë
Ankandi i pasurisë fillon me cminim fillestar në masën 42,056 Euro
Ankandi do të zhvillohet në datë 21.02.2018 në orën 15:00 në selinë e shoqërisë Buv "Gjergj Fishta" Palli i Shoqërisë "Gor" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit duhet të paraqiten ose të kontaktojnë tel. 06355 57 28 543 ose e-maili llir_durveshaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com

REFORMAT TAKSAT

Tarifë për përdorimin e ujit të puseve, deputeti i PD çon propozimin në Kuvend

Amendamenti për puset, PD: Asnjë taksë për 300 familje

Hasa: Pengojmë arbitraritetin e qeverisë

Valentina Madani

Partia Demokratike kërkon taksë zero për përdorimin e ujit të puseve për familjet në fshat dhe në qytet. Sipas demokratëve, familjet në fshat dhe qytet që përdorin ujë të puseve duhet të jenë të përjashtuara nga pagesa e tarifës së ujit. Deputeti demokrat Endri Hasa depozitoi dje në parlament amendamentin që përjashtoi nga pagesa familjet në fshat dhe qytet, që përdorin puset për t'u furnizuar me ujë. Në projektligj kjo tarifë nuk është e përcaktuar, pasi për këtë pritet dalja e akteve nënligjore. Sipas PD-së, në projektligjin e Ministrisë së Bujqësisë, tarifa e përdorimit të ujit nga puset nuk përcaktohet, duke e lënë atë në vullnetin e qeverisë. Për të penguar arbitraritetin e qeverisë, deputeti Endri Hasa propozon që të vendoset në ligj përjashtimi nga tarifat për çdo familje që nëpërmjet puseve, plotëson nevojat familjare për ujë apo i përdor puset për qëllime bujqësore dhe blegtorale. Ministrisë së Bujqësisë i mungojnë të dhënat e familjeve që përdorin puset për këto qëllime, por sipas të dhënave të INSTAT për ata që jetojnë në fshat, janë rreth 300 mijë familje përfutuese nga nisma e Partisë Demokratike, nëse ajo do të pranohet nga qeveria. Amendamenti i depozituar nga deputeti demokrat, Endri Hasa, parashikon edhe që fushata 6-mujore për informimin e qytetarëve dhe plotësimin e dokumentacionit të zgjerohet në dy vjet, për t'u dhënë përdoruesve të puseve kohë të mjaftueshme për regjistrimin e tyre. Para pak kohësh kryeministri Edi Rama bëri të ditur se do të pajisen me autorizim edhe ujërat e puseve në shtëpi. Rama është shprehur se



Selia e PD-së

çdokush që përdor ujërat nëntokësorë duhet të formalizohet dhe ata që nuk janë të tillë do të mbyllet. Nuk dihet nëse ky formalizim i Ramës ka të bëjë vetëm me pajisjen e autorizimit dhe disa dokumente apo do të ketë një ven-

dosje matësish edhe për qytetarët që marrin ujë nga puset. "25 000 puse nga të cilat 265 kanë leje. Kjo është një barbari për shkak edhe të braktisjes së punës nga shteti. Brenda vitit 2018, çdo konsumator që përdor apo dëshi-

PROPOZIMI

Sipas amendamentit të opozitës, familjet në fshat dhe qytet që përdorin ujë të puseve duhet të jenë të përjashtuara nga pagesa e tarifës së ujit. Bëhet fjalë për rreth 300 mijë familje, kryesisht në fshat, që përdorin ujë të puseve që kanë hapur vetë, qoftë për ujë të pijshëm, qoftë për vaditje.



Foto ilustruese

PROJEKTLIGJI

Në projektligj tarifa nuk është e përcaktuar, pasi për këtë pritet dalja e akteve nënligjore. Sipas PD-së, në projektligjin e Ministrisë së Bujqësisë, tarifa e përdorimit të ujit nga puset nuk përcaktohet, duke e lënë atë në vullnetin e qeverisë.

Sorollatja, strategji për edukimin ligjor

Hysi: Të informohen qytetarët për ligjet e reformës në drejtësi

Disa prej ligjeve të reformës në drejtësi kanë nisur zbatimin, por qytetarët që nuk kanë dijeni mbi to ende sorollaten dyerve të institucioneve. Për të evituar këtë fenomen është hartuar strategjia për edukimin ligjor të publikut, e cila po diskutohet me shoqërinë civile. Strategjia pritet të miratohet brenda muajit mars. Aksesit i qytetarëve në njohuritë mbi ligjin është themelor për garantimin e një sistemi në drejtësi efektive. Në këtë kuadër është hartuar strategjia për edukimin ligjor të publikut, përmes së cilës synohet informimi i qytetarëve mbi ligjet e reja të reformës në drejtësi. Në tryezën e konsultimit me përfaqësues të shoqërisë civile, zëvendëskryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi tha kjo strategji do të mund të evitojë sorollatjet e qytetarëve në in-



stitucione. "Më vjen keq që e them se megjithëse kanë dy vite që kanë hyrë në fuqi një pjesë e ligjeve që lidhen me sistemin e drejtësisë, qytetarët nuk arrijnë të shfrytëzojnë atë akses që ligjet i kanë mundësuar atyre duke shmanjur proceset e gjata dhe të kushtueshme", tha zj.Hysi. Një sfidë për Vasilika Hysin mbetet buxheti për strategjinë

REFORMA

Disa prej ligjeve të reformës në drejtësi kanë nisur zbatimin, por qytetarët nuk kanë dijeni mbi to dhe ende sorollaten dyerve të institucioneve. Për të evituar këtë fenomen është hartuar strategjia për edukimin ligjor të publikut, e cila po diskutohet me shoqërinë civile.

e edukimit ligjor: "Sfida që ne kemi është buxheti, sepse kjo strategji ka kosto", theksoi ajo. Kjo është strategjia e parë kombëtare për edukimin ligjor të publikut, ajo pritet të miratohet brenda muajit mars të këtij viti. Pas miratimit të saj në Kuvend, do të nisë puna për ngritjen e rrjetit të punonjësve si dhe trajnimin e tyre.



HEC-et, Braçe: Qeverisë i ka ikur vullneti, babëzi e madhe

Deputeti socialist, njëherësh kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe reagoi ashpër ndaj planit për ndërtimin e 3 HEC-ëve në Osum. Ai shprehet se nuk luftoi me kolegët socialistë që të miratohen projektet skandaloze të Berishës. "Nuk luftuam 8 vite që hidrocentralin në Osum të miratohet tani! Kjo e hidrocentraleve në Osum nuk është histori e re, e vjetër sa s'ka është. Nuk është çështje e investimeve të rëndësishme, babëzi e madhe është. Nuk është punë e atyre që kanë emrat - të parëndësishëm në treg janë. Nuk është as çështje koordinatash, gjurmë aty ku do ngrihen - i gjithë Osumi njësoj është. Është çështje vullneti. Kontrata e parë për ndërtimin e këtyre hidrocentraleve është lidhur një javë para se të largohej Sali Berisha nga qeveria. Për ato kontrata kanë pasur një ligjërimit të ashpër e akuzat të rënda nga ne për ministrin e fundit të Energjisë në qeverinë 'Berisha'. Ai po ishte vullnet! Puna është se rrugës që vullnet paska ndryshuar, është punuar nga pak çdo ditë për të shkuar në një kontratë të re. Tani po ua them shokë: Unë dhe kolegët e mi nuk luftuam 8 vite me radhë, deri ditën e fundit që të gjithë çfarë kemi denoncuar të realizohet sot, me vendime haptazi në dëm të interesit publik. Nuk kam më asnjë dëshirë të dëgjoj ligjërimit e zakonshme e të përsëritura me 'siguri juridike' për këto kontrata e këta përfutues! Nuk është në interesin publik të këtij vendi, ndërtimi i hidrocentraleve në Osum dhe kaq! Gjithçka tjetër është dëm i madh", shprehet Braçe.

VRASJA NE TIRANE INTERVISTA

Ina Allkanjari

E gënjen tim bir, ai është i urtë, kanë përfitu ar nga pika e tij e dobët. Jemi shumë të varfër. I kam hequr shpresat. Nuk e kam takuar djalin që në momentin e arrestimit. Nuk e besoj që Eltoni është përfshirë në një grup kriminal, ku i njohu ata persona". Kështu u shpreh 75-vjeçari Hydai Halipaj, babai i Eltonit, njërit prej personave që ka rënë në prangat e policisë, pasi dyshohet të jetë bashkëpunëtor në vrasjen e Devi Kasmit. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", 75-vjeçari na tregon me lot në sy momentin e arrestimit të Eltonit dhe pamundësinë ekonomike për ta ndihmuar: "Mamaja e Eltonit është e sëmurë me tumor, ka nevojë që t'i qëndroj afër në çdo moment, jam 75 vjeç, nuk kam as fuqi dhe as para që të ndihmoj tim bir. Jam në gjendje shoku, por po përpiqem me sa kam mundësi që ta mbështes", shprehet babai i Eltonit.

Si e përjetuat momentin e arrestimit të Eltonit, kishit dijeni që ai ishte i përfshirë në një grup kriminal?

Jam akoma në gjendje shoku, ditën që arrestuan Eltonin nuk më besohej që bëhej fjalë për tim bir. Ai asnjëherë nuk është shoqëruar më njëherë të tillë. Jam shumë i shqetësuar. Mamaja e Eltonit është e sëmurë me tumor, na ka sjellë një stres të madh në familje.

Si silljet Eltoni ditët e fundit përpara arrestimit, a vutë re diçka ndryshe tek ai?

Eltoni ka qenë gjithmonë i përkushtuar me familjen, sidomos ndaj mamasë dhe çdo moment interesohet për shëndetin e saj. Por pesë ditët e fundit përpara se të ndodhte e gjithë kjo, ai nuk vinte

Flet babai i Elton Halipaj, njërit prej të akuzuarve si bashkëpunëtor i vrasjes së Kasmit

Hydai Halipaj: Java e fundit e Eltonit para vrasjes

"Jam në gjendje shoku, jemi të varfër, nuk e ndihmoj dot"



Elton Halipaj

shpesh në shtëpi, veç telefononte i shqetësuar dhe pyeste si ishte e ëma, apo nëse i kishte pirë ilaçet. Nuk kishim dijeni se me çfarë po merrej.

A i njihnit personat e tjerë që janë arrestuar së bashku me djalin tuaj. Ishit të informuar me kë shoqërohej Eltoni?

Nuk e besoj që im bir është përfshirë në një grup kriminal, ai është i ndershëm, ku i njohu ata persona? Ai ka shokë

qëri tjetër, s'e kam parë kurrë të shoqërohej me ata. Ai rrinte me djemtë e lagjes këtu në Yzberisht. Thuhej nga policia që im bir ka siguruar mjete, por im bir nuk i ka pasur aq lekë sa për të blerë fuginin. Në jemi kaq të rënduar ekonomikisht, ai ishte gjithë kohës nëpër spitale, pasi mamasë së tij iu rikthye tumori.

Si është e shkuara e Eltonit, a ishte ai në marrëdhënie pune?

Im bir ka bërë punë të

U arrestua si bashkëpunëtor në vrasjen e Kasmit, Meshini apelon masën e sigurisë

Idyshuari si bashkëpunëtor në vrasjen e Devi Kasmit mbrëmjen e 29 janarit, Mario Meshini, apeloj ditën e djeshme masën e sigurisë "Arrest në burg" dhe kërkoi zbutje të saj. Avokati i tij depozitoi ankimin në Gjykatën e Apelit. 24-vjeçari Mario Meshini ishte i pari i arrestuar në lidhje me atentatin e Kasmit dhe për të u caktua masa arrest me burg. Më herët gjatë seancës për caktimin e masës së sig-



Mario Meshini

nuk arrij ta besoj.

Kush po e ndjek çështjen e Eltonit, kenë siguruar një avokat?

Ditën që kanë arrestuar Eltonin, ka qenë me letrat e spitalit të së ëmës në xhëp dhe me 700 lekë të vjetra. Me vështirësi i morëm edhe avokat. Jam 75 vjeç, nuk kam as fuqi dhe as para, por po e ndjek çështjen dhe po bëj çdo gjë për të ndihmuar tim bir, sepse ai është i urtë, nuk është marr kurrë me kriminelë.

urisë ndaj Meshinit, avokati i tij, Ferdinand Doja, kërkoi nga prokuroria të marrë pamjet filmike dhe të vërtetojë këto fakte, duke këmbëngulur se i mbrojturi prej tij nuk kishte lidhje me kriminelin. 25-vjeçari dhe avokati i tij mbrojtës theksojnë se ai ishte shok me viktimën. Por pozitën e Meshinit në krim e rëndon edhe fakti se pas krimit, 25-vjeçari nuk shkoi në polici të kallëzonte ngjarjen.

A është i martuar djali juaj?

Djali ka qenë i martuar dhe ka një gocë të vogël, por një vit e gjysmë më përpara, në të njëjtën kohë që u operua e ëma pasi u sëmur me tumor, pati probleme edhe me bashkëshorten dhe u ndanë. Eltoni ka shumë shqetësime.

Eltoni i ka mohuar akuzat, çfarë reagimi keni për këtë gjë?

Jam në errësirë... Nuk di ç'them.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,384,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **01 Mars 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: **Project Specialist on Integrity & Anticorruption**
Duty station: **Tirana**

Duration of Assignment: **1 year with possibility of extension**

Type of Contract: **Service Contract**

Educational Background: **Master degree in Political Science, Public Administration, Public Policy, Law, Sociology, Development Studies or other relevant fields.**

Work Experience: **A minimum of 5 years responsible and relevant professional working experience in the area of public policy, democratization and anti-corruption**

At least 2 years of relevant professional working experience in the area of anti-corruption, public ethics and integrity.

Experience in working with Local Government Units on issues of public ethics integrity and anticorruption. Experience with organization of national and / or international activities in the field of local governance and democratization

Demonstrated understanding of Albania's local governance system.

Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 10 March 2018

Deadline for Application: 24 February 2018

Job Description: **Available at UNDP site:**

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

SUBVENCIONET APLIKIMI

Nga 60 mijë lekë ha për ullishtat, deri në 20 milionë lekë për përpunimin e ullirit

Subvencionet për bujqësinë, ja si do të ndahet fondi 35 milionë lekë

Qeveria, mbështetje për bujqësinë dhe blegtorinë

Ornela Manjani

Mbarështimi i bletarisë, përmirësimi i menaxhimit të peshkimit, nxitja e kultivimit të sipërfaqes së tokës së papunuar dhe mbështetja e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale janë katër programet që do të mbështesë financiarisht qeveria shqiptare. Këshilli i Ministrave ka miratuar dje kriteret për të përfutur nga fondi prej 35 milionë lekësh, i cili do të mbështesë shtimin e pemëve frutore dhe serave. Masa e subvencionit do të jetë në proporcion të drejtë me vlerën e investimit, sa më i madh të jetë investimi aq më e madhe do të jetë edhe vlera e mbështetjes nga qeveria. Prioritet në subvencion do të kenë fermerët e rinj. Subvencionet do të nisnin nga 60 mijë lekë/ha ullishte të mbjellë deri në 20 milionë lekë për makineritë dhe pajisjet e përpunimit të tji.

FERMERËT

Fermerët që kultivojnë të paktën 5 ha tokë bujqësore, në pronësi private ose me qira, do të subvencionohen në vlerën 25 mijë lekë për grurin dhe elbin, si dhe deri në 20 mijë lekë për thekrën, tërshërën dhe koçkullën. Fondet do të jenë të disponueshme edhe për zhvillimin e teknologjive të kultivimit, në mënyrë që bujqësia shqiptare të ketë mundësi të modernizohet dhe të sjellë inovacione.

BLEGTORËT

Mbarështimi i bletarisë do të mbështetet me një vlerë prej 1 mijë lekësh për koshere për feramat me mbi 100 koshere, për një mbështetje jo më të madhe se 150 mijë lekë. Në vendim thuhet se fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2018 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri "Transfer të në buxhetet familjare", për mbështetjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, peshkimit, agropërpunimit dhe zhvillimit rural, të përdoret për: a) rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të mbjella me kultivarë të kërkuar nga tregu, përmirësimi të teknologjive të kultivimit,

certifikimit të produkteve, rritjes e përmirësimi të kapaciteteve të grumbullimit, ruajtjes, pastrimit, selek-

sionimit, paketimit e përpunimit të tyre; b) përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve

blegtorale, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara të lindjeve të reja, pagesave për dorëzimin e qumështit cilësor, investimeve në thertore, në pikat e grumbullimit e të përpunimit të produkteve, makineri dhe pajisje në fermat blegtorale; c) nxitjen e formalizimit dhe kooperimit të prodhuesve nëpërmjet pagesave për furnizimin me inpute dhe pagesave ndaj prodhimit të dorëzuar.

Fondet

Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018 të përdoret shuma prej 35 000 000 lekësh, nga të cilat: • 30 000 000 lekë, për bashkëfinancimin e projekteve IPA. Përdorimi i këtyre fondeve do të realizohet sipas marrëveshjes përkatëse të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Bashkimit Evropian; • 5 000 000 lekë detyrime, për pagesat e normës së interesave bankare për kontratat e lidhura.




Foto ilustruese

PËR RRIJTJEN E KONKURRUESHMËRISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE

■ Mbjellje të reja të drufrutorëve dhe bimëve mjekësore dhe aromatike:

1. Mbjellje e mollës me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 350 000 lekë/ha për pemëtoret intensive dhe në vlerën 250 000 lekë/ha për pemëtoret me teknologji të përmirësuar;
2. Mbjellje e qershisë me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 250 000 lekë/ha;
3. Mbjellje arrash me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 300 000 lekë/ha për mbjelljet me fidanë të shartuar;
4. Mbjellje e lajthisë dhe shegës me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 250 000 lekë/ha;
5. Mbjellje gështenje, në vlerën 150 000 lekë/ha;
6. Mbjellje e ullinjve me fidanë autoktonë, në vlerën 250 000 lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 180 000 lekë/ha, për format tradicionale;
7. Plotësimi i numrit të bimëve në ullishtat e vjetra/të degraduara, në vlerën 60 000 lekë/ha;
8. Mbjellje e agrumeve me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 200 000 lekë/ha;
9. Mbjellje vreshti, me kultivarë për rrush tavoline, në vlerën 300 000 lekë/ha, dhe vreshta me kultivarë autoktonë për përpunim, në vlerën 350 000 lekë/ha;
10. Mbjellje luleshtrydesh në serra dhe/ose tunele, në vlerën 200 000 lekë/ha;
11. Mbjellje bimësh mjekësore dhe aromatike, të kultivuara, si: timus, rigon, helichrysum italicum, trumza, çaj mali, rozmarinë, xinxher dhe shafran të kësaj shkroneje, të jetë jo më e madhe se 20 ha, sipas kategorive të mëposhtme:

■ Sipërfaqet përfituese

Sipërfaqja e mbjellë me kulturat e përcaktuara në nëndarjet timus, rigon, helichrysum italicum, trumza, çaj mali, rozmarinë, xinxher dhe shafran të kësaj shkroneje, të jetë jo më e madhe se 20 ha, sipas kategorive të mëposhtme:

1. Për fermerët individualë, jo më pak se 0.5 ha në një bllok të vetëm dhe jo më pak se 0.3 ha, kur i bashkëngjitet blloqeve ekzistuese;

2. Për grup-fermerësh, jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm;
3. Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (në vijim SHBB), jo më pak se 5 ha, ndërsa madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.3 ha, kur nuk është në bllok.

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë të jetë:

1. Deri në 5 ha, me 100% të vlerës për hektar;
2. Mbi 5.0 - 10 ha (5 hektarët e dytë), të rritet me 25% të vlerës për hektar;
3. Mbi 10.0 ha deri në 20 ha, të rritet me 50% të vlerës për hektar.

MASA E FINANCIMIT TË JETË NË 50% TË VLERËS TOTALE TË FATURAVE TATIMORE PËR

1. Përmirësimin e teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume, arroje dhe shegë (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), jo më shumë se 200 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.5 ha dhe jo më shumë se 5 ha;
2. Instalimin e sistemit të ngrohjes me biomasë (pelet) në serrat me ngrohje, jo më shumë se 280 000 lekë për dynym. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha;
3. Zëvendësimin e plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese, sipas specifikimeve të nënpikës 2.1, shkronja "b", jo më shumë se 750 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha;
4. Prodhimin e bostanoreve në tunele (mulçerimin dhe mbulimin me plastmasë termikë), jo më shumë se 100 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.5 ha dhe jo më shumë se 5 ha;
5. Rrjetat për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese të kulturës së mollës dhe qershisë, jo më shumë se 1 500 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 ha dhe jo më shumë se 5 ha;
6. Polenizimin e kulturave perimore në serra me bletë polenizuese, jo mjaltdhënëse, jo më shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha, për sipërfaqe jo më shumë se 5 ha;
7. Projektet për sistemet e automatizimit të kontrollit në serra, për eficiencën e energjisë dhe/ose për instalimin e sensorëve të kontrollit të klimës në serra, jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha.



Kur aplikuesi ka tokë në pronësi merr 25 % të investimit

Fermerët e rinj, serra në jo më shumë se 1 ha

Qeveria do t'i japë prioritet subvencionit për fermerët e rinj. Në vendimin e miratuar dje thuhet se për fermerët me moshë nga 22 deri në 35 vjeç, masa e financimit të rritet me 25%. Aplikuesi, në çdo rast, duhet të ketë tokën në pronësi private dhe/ose të marrë me qira nga subjekte të tjera që e kanë tokën në pronësi private. Sipas vendimit për ndërtimin e serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit, me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se: 1 500 000 lekë/dynym, për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika dhe 1 300 000 lekë për dynym, për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika. Masa e financimit për sipërfaqe të jetë: nga 0.20-0.50 ha me 100% të vlerës për hektar; dhe mbi 0.51-1 ha të rritet me 25% të



VENDIMI

Në vendimin e miratuar thuhet se për fermerët me moshë nga 22 deri në 35 vjeç, masa e financimit të rritet me 25%. Aplikuesi, në çdo rast, duhet të ketë tokën në pronësi private dhe/ose të marrë me qira nga subjekte të tjera që e kanë tokën në pronësi private.

vlerës për hektar. Qeveria ka miratuar subvencion për pritje dhe përmirësim i kapaciteteve të grumbullimit, ruajtjes, pastrimit, seleksionimit, paketimit dhe për-

bullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta, perime dhe prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), jo më shumë se 20 000 000 lekë për një subjekt dhe për ambiente grumbullimi për fruta dhe perime, jo më shumë se 10 000 000 lekë për një subjekt. Mbështetje nga qeveria do të marrin edhe linjat e përpunimi/makinieri, pajisje për fruta - perime, vaj ulliri dhe verë, jo më shumë se 20 000 000 lekë për një subjekt dhe linjat e seleksionimi, paketimi, pastrimi, përfshirë dhe ambalazhe për fruta, perime dhe bimë mjekësore e aromatikë, jo më shumë se 5 000 000 lekë për një subjekt. Linjat për filetimin, tharjen, tymosjen e produkteve peshkore nga liqenet do të marrin subvencione jo më shumë se 3 000 000 lekë nga organizatat e menaxhimit të peshkimit.

Mbjellja e grurit dhe elbit në tokë me qira, subvencionohet nga qeveria

Ornela Manjani

Pika e grumbullimit i paguan fermerit jo më pak se 50% të vlerës së subvencionuar të fidanit. Mbështetja nga qeveria do të shkojë për pikat e grumbullimit dhe fermerët për vlerën e fidanëve të domates, specit, kastravecit dhe bostanoreve të shitur ndaj fermerëve, deri në 50% të vlerës së faturës tatimore, por jo më shumë se 12 lekë për fidan. Në vendim qeveria ka parashikuar edhe pagesa për 50% të vlerës së fidanit, por jo më shumë se 12 lekë ndaj grumbulluesit të kryhet kundrejt faturës tatimore dhe kontratës noteriale të lidhur me fermerët. Pagesa të kryhet kur grumbulluesi autofaturon fermerin për prodhimin e blerë dhe konfirmon pagesën ndaj fermerit. Për fermerët/subjektet që kultivojnë jo më pak se 5 ha tokë bujqësore, në pronësi private ose të marrë me qira nga fermerë të tjerë që e kanë tokën në pronësi private, mbështetja për grurin dhe elbin në vlerën 25 000 lekë/ha, ndërsa për thekrën, tërshërën dhe koçkullën në vlerën 20 000 lekë/ha.

ZONAT RURALE:

Qeveria ka miratuar mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 500 000 lekë dhe mbështetje për investime në agroturizëm kun-

Pikat e grumbullimit i paguajnë fermerit 50 % të vlerës së fidanit

Zhvillimi i zonave rurale, ja si mund të përfitoni fonde

CERTIFIKIM DHE MBROJTJE E PRODHIMEVE BUJQËSORE

1. implementimin dhe certifikimin Global GAP, në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, jo më shumë 175 000 lekë, për secilin nga produktet e përfshira në nënpikën 2.1, si dhe për lakrën, lulëlakrën dhe brokolin për sipërfaqe të mbjellë, por jo më pak se 1 ha;
 2. standardet IFS (Standardi Ndërkombëtar i Ushqimit), BRC (Konsorciumi Britanik i Shitjes me Pakicë) dhe/ose FS (Miq të Detit) në stabilimentet e përpunimit të prodhimeve peshkore, në masën 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 325 000 lekë për standard për produkt;
 3. fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 lekë, për ferme? te? certifikuar;
 4. implementimin dhe certifikimin për standardin ISO 22000:2005, për operatorët e biznesit ushqimor, në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë se 120 000 lekë;
 5. primin vjetor të siguracionit të prodhimeve bujqësore, në masën 50% të vlerës, por primi të mos kalojë vlerën 4% të totalit të aseteve të siguruara.
- PËR PËRMIRËSIMIN E ZINXHIRIT TË SIGURISË USHQIMORE TË PRODUKTEVE BLEGTORALE:**
1. Për krerë të lindur të matrikulluar, për fermat me mbi 100 krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë dhe për fermat me mbi 10 krerë lopë, në vlerën 2 000 lekë/krerë;
 2. Për enë të certifikuar për transportin e qumështit nga

- ferma në pikat e grumbullimit e të përpunimit, deri në 70% të vlerës për njësi, por jo më shumë se 2 500 lekë/njësi.
3. Ndërtimin e thertoreve, ambienteve të përpunimit të produkteve blegtorale dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 20 000 000 lekë, dhe për rikonstruksion/pajisje në thertoret ekzistuese për plotësimin e standardeve të legjislatcionit në fuqi, jo më shumë se 10 000 000 lekë;
4. Ndërtimin e pikave të reja të grumbullimit të qumështit dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë;
5. Ndërtimin e ambienteve për mbarëshkrimin e kafshëve, stabilimenteve për rritjen e shpendëve, si dhe makinieri e pajisje për mekanizimin e modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale me jo më pak se 10 lopë, jo më pak se 100 të imëta, jo më pak se 10 drosa dhe kapacitet jo më pak se 10 000 shpendë, por jo më shumë se 15 000 000 lekë;
6. sistemet ftohëse të qumështit për pikat e grumbullimit dhe/ose përpunimit, jo më shumë se 1 000 000 lekë;
7. përmirësimin e infrastrukturës së tregjeve të kafshëve, jo më shumë se 4 000 000 lekë për treg;
8. Mbështetjen për dorëzimin e qumështit, lëndë e parë, që plotëson standardet në fuqi, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat me mbi 15 krerë lopë, kundrejt faturës tatimore të shitjes dhe raport-analizës laboratorike përkatëse.
9. Për mbarëshkrimin e bletarisë, mbështetje me 1 000 lekë për koshere, për ferma me jo më pak se 100 koshere bletë, dhe masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 lekë.

drejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 lekë. Për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, qeveria do të subvencionojë 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 lekë. Subvencion do të ketë edhe për makinieri dhe pajisje për prodhimin e produkteve tradicionale të zonës deri në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 lekë. vendimi parashikon mbështetje për çdo sipërmarrje të re (start-up) nga individë të moshës nga 22 deri në 35 vjeç, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 lekë.

STANET

Blegtorët do të marrin mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imëta (rikonstruksion dhe pajisje me panele fotovoltaike), në 80% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 lekë dhe për ngritjen e inkubatorëve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 lekë, kundrejt planit të biznesit. Shitja e produkteve ushqimore të prodhuara në vend do të mbështetet financiarisht në bazë të planit të biznesit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 2 000 000 lekë.

Ekonomia informale e Shqipërisë është rritur përgjatë viteve 2014-2015 sipas një studimi të posaçëm që ka bërë Fondi Monetar Ndërkombëtar. Të dhënat e publikuar nga FMN tregojnë se në vitin 2015 ekonomia informale e Shqipërisë arriti në 26.2 për qind, teksa në vitin 2013 ky tregues ishte 25.6 për qind. Fondi ka gjetur se madhësia e ekonomisë në hije është rritur edhe pse qeveria shqiptare në vitin 2015 ndërmoi një aksion të gjerë



Ekonomia informale në Shqipëri, në rritje për 2014-2015

FMN: Rritja e taksave shtoi informalitetin

antiinformalit. Ekonomia informale e Shqipërisë arriti në minimumin e saj në 25.52% në vitin 2012 ndërsa maksimumi i saj ishte në vitin 1990 me 43.1 për qind të saj. Por treguesi i mesatarizuar i ekonomisë së zezë sipas Fondit është 32.72%. Sipas Fondit, renditet e 54 në botë për madhësinë e ekonomisë informale në

raport më PBB, mirëpo disa vende afrikane të tilla si Gana, Nanbia, Bostuana renditen shumë më mirë se Shqipëria. FMN ka publikuar rezultat në lidhje me ekonominë e zezë për periudhën 1990-2015 për 158 vende. Madhësia mesatare e ekonomisë hije në 158 vendet është 31.9 për qind, teksa Shqipëria e ka ekonom-

inë gri mbi mesataren botërore. Madhësia e informalitetit është më e lartë në Zimbabve me 60.6 për qind dhe Bolivi me 62.3 për qind të PBB-së. Më e ulta është në Austri me 8.9 për qind dhe Zvicra me 7.2 për qind. FMN vlerëson se ekonomia e zezë për nga natyra është e vështirë për t'u matur, pasi gjetja e aktiviteteve në të

zezë është e vështirë për tu zbuluar Kërkesa për informacion në lidhje me ekonominë e zeze është rritur me kalimin e kohës e motivuara nga rëndësia politike dhe ekonomike. Për më tepër, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik, duke përfshirë prodhimin zyrtar dhe jozyrtar të mallrave dhe shërbimit është thelbësorë në hartimin e politikave ekonomike që i përgjigjen luhatjeve dhe ekonomike zhvillimin me kalimin e kohës dhe në të gjithë hapësirën.

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit zbardh abuzimet për periudhën 2014-2016

KLSH: Institucionet publike, 825 milionë euro dëm buxhetit

Keqpërdorimi i fondeve, kryeson qiradhënia shtetërore

Ornela Manjani

Reth 825 milionë euro janë "zhdukur" nga buxheti i shtetit në tre vjet, për periudhën 2014-2016. Dëmi është shkaktuar nga institucionet publike, të cilat ose kanë abuzuar me fondet ose nuk kanë arkëtuar të ardhurat. Dëmi është ndarë dy grupe, në parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, të cilat përbëjnë një dëm prej totale prej 11.5 miliardë lekë ose 85.8 milionë euro. Të dhënat janë bërë të ditura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në raportin përfundimtar për vitin 2017 ku jepen edhe detajet për fushat ku janë kryer më shumë shkelje. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2014-2016, përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

DËMI
Kontrolli i Lartë i Shtetit shkelja e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 99.05 miliardë lekë, afërsisht 739.7 milionë euro nga e cila: 92.7 miliardë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 692.1 milionë euro dhe 6.3 miliardë lekë afërsisht 47.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficientë dhe efektivitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliardë lekë ose afërsisht 825.6 milionë euro. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë një vlerësim lidhur me detyrimet tatimore dhe doganore. "Për vitin 2016 rritja e detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave (borxhi tatimor dhe doganor) si dhe



skemës së sigurimeve shoqërore është në vlerën 51.17 miliardë ose 41% më e lartë se viti 2015" vlerëson KLSH. Rekordin për dëmet më të larta sipas fushës e mban pjesa e shitjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore që rezultojn me një vlerë 4.1 miliardë lekë. Më pas në vendin e dytë është pjesa e riblerjes së pasurisë

shtetërore me 2.89 miliardë lekë. Doganat janë të renditura si të tretat me një vlerë dëmi të konstatuar prej 1.9 miliardë lekë kurse prokurimet në vendin e katërt me 1.58 miliardë lekë. Grupi i tatimtaksave rezultojn me një dëm prej 370 milionë lekë për t'u pasuar nga shpenzimet operative me 251 milionë lekë. Në fund dëmi më i

vogël është konstatuar në fushën e pagave shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore me 91 milionë lekë dhe në fund urbanistika me 8.8 milionë lekë. Pjesa e mbetur e sektorëve të audituar, por që nuk klasifikohet në asnjë nga fushat e mësipërme është grupuar nën emërtimin "Të tjera" me një vlerë 503 milionë lekë.

Përcaktohet shpërblimi për një vakt ushqim

VKM-ja, dreka në punë, paguhet nga punëdhënësi

Qeveria ka miratuar sot vendimin për përcaktimin e kufijve dhe kriterëve të shpërblimit që i korrespondon pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushime vjetore. Sipas këtij vendimi, punëdhënësit, të cilët nuk mund të sigurojnë lokal për ngrenie me kusht higjienike të pranueshme, duhet t'i shpërblejnë punëmarrësit për ushqimin që konsumohet gjatë pushimit në ndërmarrje. Referuar vendim-

it, masa e shpërblimit është e barabartë me diferencën e çmimit të ushqimit, në rastet kur ky i fundit përgatitet nga i punësuar ose në kuzhinë të përbashkëta me çmimet me pakicë në restorante. Ndërkohë, lidhur sa i takon vlerës, mënyrave dhe kriterëve të dhënies së pagës në natyrë, sipas vendimit kufiri i vlerës së shpërblimit në formën e pagës që është përcaktuar të jetë deri në masën 300 lekë për një vakt. Ndërsa, kur trajtohet me më shumë se një vakt për ditë punë, pagesa

në natyrë parashikon masën deri në 500 lekë. Po ashtu, sipas vendimit në kontratat kolektive apo individuale të punës, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit, palët mund të përcaktojnë edhe trajtimet të tjera si dhe ndryshimin e pagesës në natyrë. Vendimi parashikon që shpërblimi në formën e pagës në natyrë mund të jepet në tre forma: në trajtim ushqimor, kupon dhe mall. Në rastet kur nuk mundësohet dhënia e shpërblimit në asnjërin prej tre formave të përmendura më lart, punonjësit do të mund ta marrin shpërblimin në para, i cili trajtohet si pagë për shkak të efekteve fiskale. Ndërkohë, në rastet kur paga në natyrë zbritet nga paga e punonjësit, atëherë sipas vendimit shumica e këtij shpërblimi nuk mund të kalojë 20% të pagës mujore.



Deeuroizimi, Banka e Shqipërisë miraton masat e para

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë të mërkurën hapat e parë konkrete në qëllimin e saj për uljen e euroizimit të ekonomisë. Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës u miratua një dokument që përcakton mënyrën dhe format sesi Banka Qendrore do të kontribuojë në këtë proces, si edhe disa ndryshime në rregulloret e mbikëqyrjes bankare, që në thelb do të rrisin kostot për veprimtarinë në valutë të sistemit bankar. "Në këtë kuadër miratua më pari, dokumentin e politikës mbi zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e sektorit bankar dhe të institucioneve financiare jo bankare që rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Së dyti, janë miratuar sot disa ndryshime rregullative, të cilat finalizojnë punën e zhvilluar gjatë vitit të kaluar për identifikimin, vlerësimin dhe konsultimin me industrinë bankare të disa masave që mbështesin zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e sektorit bankar. Këto ndryshime rregullative synojnë ta bëjnë më të kushtueshme, pra më pak të preferuar veprimtarinë në valutë të sektorit bankar dhe të forcojnë mekanizmat e ndërgjegjësimit të huamarrësve, veçanërisht të atyre individëve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziqet që shpëtojnë huamarrjen në valutë, -tha dje Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Genti Sejko". Raporti i kredive me probleme u ul më tej gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar, duke zbritur në 13.2%, nivelin më i ulët që nga rikurimi i vitit 2010. Guvernatori përsëriti edhe njëherë bindjen e Bankës së Shqipërisë se bankat kanë mundësi të lehtësojnë më shumë politikat e kreditimit, edhe falë uljes së kredive me probleme. "Shërbimi financiar i bankave është në përmirësim të vazhdueshëm. Kjo ecuri dëshmohet nga gjendja e qëndrueshme e likuiditetit, nga ecuria pozitive e treguesve të përfutueshmërisë, si edhe nga reduktimi progresiv i raportit të kredive me probleme. Raporti i kredive me probleme ndaj kredive totale zbriti në nivelin e 13.2% në muajin dhjetor. Në këtë kontekst Banka e Shqipërisë gjykon se ka hapësirë të mëtejshme për faktorizimin e reduktimit të rreziqit të kreditit në lehtësimin e politikave të kreditimit nga ana e bankave të nivelit të dytë"-tha Guvernatori.

BSH mbajti të pandryshuar normën bazë të interesit në 1.25% dhe konfirmoi orientimin se nuk do të ketë rritje të saj, së paku, deri në tremujorin e fundit të këtij viti. Guvernatori Sejko tha se kërkesa agregate ngelet ende e pamjaftueshme për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë dhe për të mundësuar kthimin e inflacionit në objektiv.

Avokatët: Hetimi i prokurorisë i nxituar, s'u verifikuan të dhënat e kallëzimit që depozitoi Gjyknuri

Ina Allkanjari

Rruga Tiranë-Elbasan, Krimet e Rënda lenë në burg Xhikën dhe 2 ish-zyrtarët

Prokuroria: I shkaktuan shtetit një dëm prej 54 mln dollarësh

Gjykata e Krimeve të Rënda zhvilloi ditën e djeshme seancën për caktimin e masës së sigurisë ndaj ish-drejtorit të Rrugëve, Dashamir Xhika dhe 2 ish-zyrtarëve të tjerë të kësaj drejtorie, Aksel Qurduka dhe Albes Alite. Seanca gjyqësore për komunikimin e masës u zhvillua me detyrë të mbyllura. Gjyqtarja Iliriana Olldashi rikonfirmoi masën e sigurisë "arrestit me burg" për tre ish-zyrtarët. Ndaj tyre rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës, kryer në bashkëpunim dhe korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, pasi dyshohen për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan.

SEANCA GJYQËSORE

Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar ditën e djeshme pranë Krimeve të Rënda ish-drejtori i Rrugëve, Dashamir Xhika dhe 2 ish-zyrtarë të tjerë Aksel Qurduka dhe Albes Alite u njohën me masën e sigurisë "arrest me burg". Burimet bëjnë me dije se tre ish-zyrtarët nuk kanë dhënë asnjë sqarim gjatë seancës, duke preferuar të flasin në një moment të dytë. Ndërkohë jashtë sallës së gjyqit, mbrojtësit ligjorë nuk dhanë detaje për mediat. Avokatët e tyre kanë akuzuar prokurorinë se ka vepruar me urgjencë pa kryer veprime hetimore lidhur me çështjen, dhe iu është referuar pa asnjë verifikim të dhënave të kallëzimit që depozitoi ndaj tyre ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjyknuri. Ndaj Dashamir Xhikës dhe dy ish-zyrtarëve të tjerë rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës, kryer në bashkëpunim dhe korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, pasi dyshohen për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, si pasojë e të cilave



i është shkaktuar buxheti të shtetit, një dëm prej 54 milionë dollarësh. Edhe KLSH zbuloi shkelje në vitin 2016 për Tiranë-Elbasan dhe keqmenaxhim të projektit, por Ministria e Transporteve

nuk mori masa. Hetimet për shkelje në ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan, i udhëheq prokurorja e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj. Në dosjen e prokurorisë thuhet se tre

VENDIMI
Gjyqtarja Iliriana Olldashi rikonfirmoi ditën e djeshme masën e sigurisë "arrestit me burg" për Dashamir Xhikën dhe dy ish-zyrtarët, Aksel Qurduka dhe Albes Alite. Ndaj tyre rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës, kryer në bashkëpunim dhe korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, pasi dyshohen për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan.

EMERIMI



Dhimitraq Ziu komandohet drejtori i ri i Policisë së Tiranës

TIRANË - Dhimitraq Ziu do të marrë postin e drejtorit në policinë e Tiranës. Në këtë rol ai do të zëvendësojë Ardi Velin, i cili tre ditë më parë u komandua Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Ziu mbante detyrën e zv/drejtorit për rendin e policisë së Tiranës. Komandimi i Ziut në krye të bluve të kryeqytetit, do të zgjasë deri në momentin kur një oficer karriere të emërohet në këtë post. Që prej vitit të kaluar Ziu ka mbajtur postin e zv/drejtorit për Rendin në Policinë e Tiranës dhe përgjatë kësaj kohe është vërejtur shtim i prezencës së policisë. Ndërkohë Ardi Veliu është emëruar zyrtarisht në krye të Policisë së Shtetit pas shkarkimit të Haki Çakos. Emri i tij u propozua nga ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe u aprovua nga kryeministri i vendit Edi Rama.



Ekstradimi në Shqipëri, Izet Haxhia: Pas arrestimit të 'peshqve të mëdhenj', më erdhi radha

TIRANË - Izet Haxhia, ish-truproja i Sali Berishës, do të ekstradohet në Shqipëri. Lajmin e ka bërë të ditur vetë Haxhia. Në një telefonike në "Neës 24", ai u shpreh se është njohur sot (dje) me vendimin e gjykatës. Sipas tij, ekstradimi është lejuar nga Gjykata e Lartë në Turqi. I akuzuari për vrasjen e ish-deputetit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari ka ironizuar deklaratat e politikës shqiptare për arrestimin e "peshqve të mëdhenj". "Po, është e vërtetë. Sot është marrë vendimi nga Gjykata e Lartë turke për ekstradimin tim në Shqipëri. Tani si duket pas 12 vjetësh u ra ndërmend për ekstradimin tim. Si duket, me përkujdesjen e qeverisë shqiptare, e cila pasi arrestoi gjithë 'peshqit e mëdhenj', më erdhi radha edhe mua", deklaroi Haxhia. Ai është dënuar me 25 vite burg nga gjykata shqiptare në lidhje me vrasjen e ish-deputetit demokrat, Azem Hajdari.


KALLEZIMET

Për rrugën Tiranë-Elbasan janë depozituar dy kallëzime në prokurori, më i fundit i dorëzuar nga ministri Damian Gjyknuri më 12 dhjetor 2017, bazuar në një audit të brendshëm.

ish-zyrtarët në shkelje të detyrës dhe të ligjit, me veprime dhe mosveprime konkrete, me nënshkrime të amendimeve të kontratës për ndërtimin e rrugës, i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm buxhetit të shtetit. Gjithashtu, theksohet se tre ish-zyrtarët kanë likuiduar punime të kontraktuara më parë, kanë krijuar vonesa në vendimmarrjet për zgjidhjet teknike, dhe ka pasur raste kur vlera e projektit të kontraktuar është më e lartë se ajo e diskutuar dhe e miratuar në parim nga këshilli teknik. Tre ish-zyrtarët sipas organit të akuzës, dyshohet se kanë vepruar me qëllim përfitim dhe padrejtë monetar. Sakaq për rrugën Tiranë-Elbasan janë depozituar dy kallëzime në prokurori, më i fundit i dorëzuar nga ministri Damian Gjyknuri më 12 dhjetor 2017, bazuar në një audit të brendshëm.

Vidhni energji, shoqërohen 13 abonentë

TIRANË - Njësisia operacionale Task Forcë e OSHEE Tiranë zhvilloi disa kontrole blic në dy ditët e fundit, bazuar mbi informacione të marra në rrugë operative mbi abonentë që vidhni energjinë elektrike. Kontrollet janë ushtruar në zonat Laprakë, rruga "Myslym Keta", Shkozë pranë shkollës "Androkli Kostallari", në Kombinat dhe Kamëz, nga ku janë proceduar penalisht me akuzën e vjedhjes së energjisë 9 abonentë, ku njëri është shpallur në kërkim, ndërsa 4 të tjerë janë shoqëruar në komisarjat për moskallëzim krimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHKOLLË E MAGJISTRATURËS
Këshilli Drejtues

NJOFTIM

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë shpall vakand një vend, **Pedagog i Brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.**

Kandidatët aplikant duhet të paraqesin pranë sekretarisë së Shkollës së Magjistraturës, kërkesën e tyre dhe dokumentat bashkëngjitur, brenda datës **23.02.2018.**

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve fitues janë përcaktuar në nenin 264, të Ligjit nr. 115/2016 «Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë», si dhe në aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës:

Ligji parashikon se pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar;

- me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.

Kandidati aplikant preferohet të jetë profesionist i shpikuar në fushën penale.

Cdo aplikant duhet të marrë nga sekretaria e Shkollës, numrin e regjistrimit në protokoll të kërkesës për aplikim.

KËSHILLI DREJTUES I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS



SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- Apartament nr.3 me sip. 90.5 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-3, Vol.18, Fq.80, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **79.640 Euro.**
- Apartament nr.4 me sip. 103.4 m², ZVRPP Tiranë, ZK: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-4, Vol.18, Fq.81, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **90.992 Euro.**
- Apartament nr.16 me sip. 189 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-16, Vol.18, Fq.93, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **166.320 Euro.**
- Apartament nr.20 me sip. 103.5 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-20, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tiranë. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **91.080 Euro.**

Ankandi per te gjitha pasuritë e sipërcituaru zhvillohet ne date 22.02.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSPA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tiranë.

Per cdo informacion kontaktوني ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al



Nxënësi: Nuk mund të përqendrohem në fizikë për 90 minuta. Flasin drejtoreshat e shkollave



Voltiza Duro

"3 lëndë në 6 orë", si është pritur nga nxënësit, mësuesit e prindërit

Mësuesja: Nismë e paparashikuar në mes të vitit

Ashu siç ishte parashikuar, prej datës 1 shkurt në shkollat e arsimit parauniversitar në vend, filloi zbatimi i nismës "3 lëndë në 6 orë". Nxënësit janë përbalhur me ndryshimin e skemës së programit mësimor ku tashmë zhvillojnë vetëm 3 lëndë në ditë, me 90 minuta secila. Kjo nismë është pritur me qëndrime pro dhe kundër nga nxënësit, mësuesit, prindërit e vetë drejtorëve të shkollave. "Gazeta Shqiptare" ishte dhe pranë shkollës 9 vjeçare "1 Maji" si dhe pranë gjimnazit "Sami Frashëri" në kryeqytet ku mori opinionet e ndryshme nga kategoritë e sipërpërmendura në lidhje me nismën e re të MASR që po zbatohet. Sipas drejtoreshës së shkollës 9 vjeçare "1 Maji", Dorina Kuka ky projekt i ri është pritur me entuziazëm nga nxënësit e mësuesit e ka lehtësuar së tepërmi ngarkesën ditore për fëmijët. "Nxënësit dhe mësuesit ishin në pritje për mënyrën se si do të ecte kjo nismë, pra nga të dy palët pritej me shumë entuziazëm. Nxënësit përqendrohen në 1 lëndë për një kohë më të gjatë, kanë më shumë kohë të drejtojnë pyetje dhe të marrin përgjigje të shtjelluara për to. Nga ana tjetër, ngarkesa ditore e nxënësve në shtëpi është pakësuar ndjeshëm, pasi ata përqendrohen në maksimumi 3 lëndë", tregon Kuka për "GSH".

DORINA KUKA

DREJTORESHË TE "1 MAJI"

"Nxënësit dhe mësuesit ishin në pritje për mënyrën se si do të ecte kjo nismë, pra nga të dy palët pritej me shumë entuziazëm. Nxënësit përqendrohen në 1 lëndë për një kohë më të gjatë, kanë më shumë kohë të drejtojnë pyetje dhe të marrin përgjigje të shtjelluara për to. Nga ana tjetër, ngarkesa ditore e nxënësve në shtëpi është pakësuar ndjeshëm, pasi ata përqendrohen në maksimumi 3 lëndë", tregon Kuka për "GSH".



LETICIA, NXËNËSE

"NISMË POZITIVE"

"Mendoj se është një nismë shumë pozitive pasi i jep mundësinë nxënësve të çdo lloji niveli që të përgatiten pasi janë vetëm 3 lëndë. Besoj se gjithçka do të funksionojë më së miri e mësuesit do e alternojnë planin mësimor e do na krijojnë lehtësi. Është herët për të folur, por të shohim ecurinë në vazhdim", thotë nxënësja për "GSH".



ENKELEDA LAZE, MËSUESË

NISMË E PAPANASHIKUAR


"Nuk janë respektuar disa faza paraprake për të garantuar suksesin. Kjo do të thotë që duhej testuar ky format i ri. Aq më tepër që ky zbatim i nismës në mes të vitit ishte i paparashikuar. Ne jemi pro reformave, por të respektohen fazat që të garantohen suksesit, pasi e gjitha kjo sjell pasiguri"-thotë mësuesja Enkelelda Laze për "GSH".



DRITA MUSLIU, PRIND

"FËMIJËT MË TË LEHTËSUAR"

"Është mirë pasi nxënësit mësojnë vetëm për 3 lëndë e jo 6-të si më parë. Më pëlqen ky model. Fëmijët e mi tashmë janë më të lehtësuar pasi iu tepron koha që kur vijnë në shtëpi të bëjnë edhe ndonjë aktivitet tjetër argëtues jashtëshkollor." - shprehet Drita Muslia, nënë e dy fëmijëve që studiojnë në shkollën 9 vjeçare "1 Maji" për "GSH".



TEUTA DOBI, DREJTORESHË

"NË MATURA ZBATIM JO 100%"

"Deri më tani nisma është pritur shumë mirë nga mësuesit e nxënësit. Ndërsa te maturat nismën nuk do e zbatojmë 100%, por vetëm në disa lëndë, pasi nuk duam të bëjmë shumë ndryshime strukturore në program duke qenë se kanë edhe orët e konsultimeve", tregon për "GSH" drejtoresha e gjimnazit Sami Frashëri, Teuta Dobi.



vjeçare 1 Maji" e shikon me pozitivitet projektin e ri. "Është mirë pasi nxënësit mësojnë vetëm për 3 lëndë e jo 6-të si më parë. Më pëlqen ky model. Fëmijët e mi tashmë janë më të lehtësuar pasi iu tepron koha që kur vijnë në shtëpi të bëjnë edhe ndonjë aktivitet tjetër argëtues jashtëshkollor." -shpre-

het Musliu për "GSH". Por normalisht nuk mungojnë as reagimet që e shohim me skepticizëm nismën e re. Mësuesja e gjuhës angleze që jep mësim në një nga gjimnazet e kryeqytetit, njëkohësisht edhe nën-kryetare e SPASH, dega Tiranë, Enkelelda Laze shprehet se projekti, si një format i ri duhej testu-

ar paraprakisht. "Nuk janë respektuar disa faza paraprake për të garantuar suksesin. Kjo do të thotë që duhej testuar ky format i ri. Theksoj më tej se mungon një studim paraprak për vlerësimin e nevojave, analizimin e burimeve njerëzore dhe pilotimin në shkollë të ndryshme. Aq më tepër që ky

zbatim i nismës në mes të vitit ishte i paparashikuar. Ne jemi pro reformave, por të respektohen fazat që të garantohen suksesit, pasi e gjitha kjo sjell pasiguri"-thotë mësuesja për "GSH". Ndërkohë edhe nxënësi i vitit të dytë në gjimnazin "Sami Frashëri" shprehet se 2 orë fizikë apo matematikë për 90 minuta i shkak-

tojnë mungesë përqendrimi e vëmendjeje. "Bëra 2 orë fizikë njëra pas tjetres e kjo mu duk tepër e lodhshme. Në orën e parë arrita të përqendrohesha pastaj 45 minutshin tjetër më iku vëmendja totalisht. Nuk e di, por nuk më pëlqen dhe aq kjo mënyrë organizimi", tregon nxënësi për "GSH".

"Mospërputhje të vendndodhjes sipas koordinatave"



Hydrocentralet që do të ndërtohen në një zonë të mbrojtur si "Monument Kulture" në kantonet e Osumit, kanë një mospërputhje të vendndodhjes sipas koordinatave, me lejet e marra. Skandali është konstatuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, e cila i ka dërguar një memo zyrtar ministrit të Tur-

izmit e Mjedisit, Blendi Klosi ku i kërkon një rishikim të lejes për HEC-et që do të ngrihen në këtë zonë. Më tej, AKZM-ja bën me dije se leja

"Mospërputhje të vendndodhjes sipas koordinatave"

AKZM zbulon skandalin me HEC-et në Osum

mjedisore për HEC-et ka parregullsi ligjore dhe madje ka ndryshuar koordinatat ku do të ndërtohen hidrocentralet. Kjo është njësoj sikur një ndërtesë të zhvendosë një pallat përtej gjurmës së lejuar apo sikur të shtojë kate shtesë mbi lejen e miratuar. Vetëm se në përmasa më të

mëdha, sepse ka të bëjë me një hidrocentral në një mjedis ligjoristik të mbrojtur. Sipas dokumenteve, rezultoni se leja për dy HEC-et mbi kantonin e Osumit është dhënë në mars të vitit 2015 me firmën e ish-drejtorit Julian Beqiraj. Por sipas Agjencisë së zonave të mbrojtura

parregullsitë ligjore në leje dhe ndërrimi i koordinatave ku do të ndërtohen HEC-et e bëjnë lejen të paligjshme. Të martën Top Channel publikoi dokumentet që faktojnë se qeveria në mënyrë të heshtur ka miratuar ndërrimin e dy hidrocentraleve mbi kantonin e Osumit.

Shëndetësi

Nëse një i rritur mat peshën e trupit dhe e pjesëton me katrorin e gjatësisë së tij në metra, rezultati do të tregojë indeksin e masës trupore. Nëse ky i fundit është më i vogël se 20, atëherë **individit ka një peshë ideale dhe nuk është i prekur nga sëmundjet kardiovaskulare.**



Mjeku popullor: Sëmundjet e zemrës që vijnë nga mbipesha, kontrolloni IMT

Voltiza Duro

Jetojmë në një kohë që nga njëra anë ka një bollëk të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, por njëkohësisht kemi edhe në një fazë që ne nuk dimë realisht origjinën e prodhimit të ushqimeve që konsumojmë. Pra, këto produkte mund të jenë me ndërhyrje të shumta kimike, apo hormone, apo me përqindje të lartë të sheqernave, sidomos tek ëmbëlsirat. Kjo sasi e lartë karbohidratesh apo sheqernash përdoret për të mos shkaktuar dëmtimin, prishjen e këtyre produkteve të ëmbëltoreve deri sa të shkojë te konsumatori. Por që të dy faktorët e sipërpërmendur ndikojnë në atë që quhet depozitim i rezervave ushqimore në organizëm e ky i fundit fillon që këto karbohidrate t'i kthejë në dhjamë e t'i ruajë. Pra, këto depozitime nuk janë asgjë tjetër veçse një energji e pakonsumuar nga organizmi. Nëse arrijmë t'i dëgjim të gjitha kaloritë që marrim gjatë ditës, atëherë peshat trupore mbetet e pandryshuar, por kur marrim kalori më shumë sesa harxhojmë, organizmi fillon t'i depozitojë në formën e dhjamit, kryesisht në pjesën e barkut ose edhe në zonën gluteale apo kofshë. Kështu, që të kemi parasysh peshën normale të trupit, duhet të ndajmë dy faza: faza e rritjes së fëmijëve (rritja metabolike e tyre) dhe faza e qëndrimit standard të peshës trupore të të rriturit. Nëse fëmijëve duhet t'u japim kalori më shumë sesa ata dëgjin për shkak se kalojnë në fazën e tyre të zhvillimit, duhet të mos harrojmë që mund t'i japim të konsumojnë edhe ushqime që përmbajnë yndyrna nga 2-4%; ndërsa produkte shtazore mund t'u japim 50-100gramë, ndërsa ushqimet që përmbajnë karbohidrate duhet të jenë në raportin 1:4 me sasinë e proteinave që marrin.

INDEKSI I MASËS TRUPORE

Në të dyja rastet, qoftë të

YLLI MERJA: Si të luftojmë obezitetin me çajin çudibërës

"Konsumoni çaj jeshil dhe limon"



Mjeku popullor Ylli Merja

fëmijët në rritje apo të vetë të rriturit duhet të kemi parasysh që herë pas herë të kontrollojmë indeksin e peshës trupore ose masën trupore (treguesi IMT) që bazohet në gjatësinë dhe peshën trupore. Nëse një i rritur mat peshën e trupit dhe e pjesëton me katrorin e gjatësisë së tij në metra, rezultati do të tregojë indeksin e masës trupore. Nëse ky i fundit është më i vogël se 20, atëherë individit ka një peshë ideale dhe nuk është i prekur nga sëmundjet kardiovaskulare. Nëse ky indeks është 20-25, atëherë mund të themi që individit është brenda një peshe normale, por në fillimet e një obeziteti. Kur IMT rezulton 25-30, atëherë kemi të bëjmë me mbipeshë e kur parametri del mbi 30, individit vuan nga obeziteti. Kjo formulë vlen

pothuajse për të gjitha moshat, e kjo vlen edhe për fëmijët. Nëse të këta të fundit IMT del më tepër se 30, prindërit duhet të marrin masa e t'i ndërpresin të gjitha ushqimet që përmbajnë sheqerna, duhet t'i pakësojnë ushqimet shtazore që përmbajnë dhjamëra (yndyrë) si dhe të fillojnë të mësojnë fëmijën me aktivitet fizik. Një tregues tjetër që përcakton obezitetin është cirkunferenca e mesit (gjatësia e rripit të mesit) e kjo matet me një metër e nëse rezultatet dalin më shumë se 100, atëherë personi ka depozitime të dhjamit në zonën e stomakut, i njohur ndryshe si obeziteti abdominal. Ky i fundit është shumë më i rrezikshëm për shëndetin sesa dhjami që gjendet në regjionet gluteale ose në kofshë.

Pra, matja e cirkunferencës së mesit jep informacione të rëndësishme rreth rrezikut të problemeve të zemrës, për presionin e lartë të gjakut, kolesterolin e lartë, diabetin e tipit të dytë. Ky parametër te meshkujt nuk duhet të shkojë më shumë se 100, ndërsa te femrat jo më shumë se 80-85 centimetra, kjo gjith-

monë në varësi të gjatësisë. Një tregues tjetër i obezitetit është edhe sindromi metabolik, trajtimi i të cilit duhet të bëhet i gërshtuar me aktivitetet fizike si dhe me pakësimin e sasisë së ushqimeve. Gjithashtu duhet të ndërpresë dhe alkoolin. Ky grup njerëzish duhet të arrijë të ulë peshën trupore me 10 gramë në ditë.

TRAJTIMI NATYRAL

Personat mbipeshë duhet të mos konsumojnë lëngjet e konservuara të frutave apo pijet me gaz dhe së paku ta zëvendësojnë me ujë natyral si dhe 1-2 gota çaj të gjelbër në ditë, një limon të shtydhur si dhe 5-6 fije majdanos në ditë. Edhe lëvorja e limonit është shumë efektive për rënien në peshë, ku brenda 25 ditëve shihen rezultatet. Kur personi ka diabet dhe kolesterol të lartë, duhet patjetër

të synojë rënien në peshë, pra duhet t'i shpallë luftë të "heshtur" mbipeshës së trupit të tij e të bjerë minimalisht 200-300 gramë në një javë. Gjithashtu, të mos konsumojë më bukë të bardhë, por ta zëvendësojë me produktet bimore që kanë fibra, veçanërisht thekra. Nëse obeziteti i fëmijëve bëhet shqetësues, atëherë duhet të mbahet nën kontroll sasia e ushqimeve si dhe të shtyjë fëmijën që të merret me ushtrime fizike, por edhe me basketboll. Nëse një person është obez, së paku duhet të rregullojë tretjen duke pirë 1-2 gota ujë të ngrohtë në mëngjes të shoqëruar me një lugë kafe mjaltë dhe gjysmë lugë kafe piperi të z. Mjalti arrin të gjallërojë punën e enzimave në organizëm, të largojë toksinat dhe të nxitë funksionin e jashtëqitjes. Gjithashtu, për të gjithë personat mbipeshë këshillohet të konsumojnë 3-5 vakte duke ngrënë patjetër mëngjesin çdo ditë. Edhe çaji me dellinjën e zezë i kombinuar me bishat e qershisë ndihmon në largimin e ujit të tepert nga organizmi. Një mënyrë tjetër për rënien në peshë është edhe përdorimi i çajit natyral për dobësim, e kjo përzjerje bishësh do të ndihmojë edhe sistemin e tretjes dhe në jashtëqitje. Ky çaj që përmban edhe mëshiteknë bën që uji i tepert të largohet nga organizmi, pa larguar kripërat minerale.



ELBASAN - "Elbasani rezulton pikë e nxehtë e grupeve kriminale tashmë të sofistikuar, moderuar dhe prezent në jetën publike të qytetit duke investuar në tregun privat dhe punët publike. Duhet të hetohen në mënyrë efikase, e shkuara dhe e tashmja e personave me precedentë kriminalë dhe me pasuri të dukshme ardhur në mënyrë të paligjshme". Kështu deklaroi dje Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku. Pas Shkodrës, ajo ndali dhe hapin në Elbasan, ku mori pjesë në analizën vjetore të prokurorisë si dhe në përrimin e godinës së re të organit të akuzës në këtë qytet, e cila është pajisur me teknologji dhe siguri të lartë. Gjatë fjalës së saj, kryeprokurorja Marku u shpreh se, "prokurorët në bashkëpunim me Policinë e Shtetit duhet të bëjnë analiza

Pak orë pas deklaratës, plagoset në atentat miku i Çapjave

Kryeprokurorja Marku: Elbasani, pikë e "nxehtë" për grupet kriminale, hetoni!



Vendi ku ndodhi plagosja

të përbashkëta në lidhje me çështjet e pezulluara, të identifikojnë pikat e dobëta të tyre, veprime që mund të çojnë në identifikimin e autorëve dhe të rifillojnë hetimet duke sh-

tuar kapacitetet profesionale në funksion të zbulimit dhe ndëshkimit të autorëve. Pavarësia e prokurorëve në rrethet nuk do të thotë pavarësi nga ligji". Ndërkohë, ajo u

shpreh se, "nuk duhet të qëndrojmë vetëm pas qytetarit që kryen korrupsion, por të shtrihemi edhe më tej duke siguruar bashkëpunimin e tij për të goditur funksionarin që pranon këtë korrupsion". Por, disa orë pas deklaratës së kryeprokurorës së përkohshme për të luftuar grupet kriminale (rreth orës 19:45) në lagjen "Fushë Mbret" të qytetit të Elbasanit u plagos në një atentat me armë zjarri një 23-vjeçar. Burime nga policia lokale pohuan se Raif Çaushllari, i cili njihet si mik i fisit Çapja (ka në pronësi një motoservis) është plagosur me një plumb në krah, teksa po



Kryeprokurorja Marku gjatë takimit në Elbasan

lëvizte në këmbë dhe se ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa, mësohet se vëllai i të riut rezultoi të jetë person me precedentë penal, por ende nuk dihet nëse kjo ka lidhje me ngjarjen e mbrëmshme. Ndërkaq, policia e mbështetur nga forcat e

Ndërhyrjes së Shpejtë ka nguritur disa pika kontrolli dhe bënë krehjen e zonës ku ndodhi ngjarja. Blutë po hetojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje si dhe identifikimin e vënien në pranga të autorëve të krimit.

Babai i të akuzuarit për përndjekje: Faji i vjehrrës, nuk do lidhjen e vajzës me djalin

U arratis nga tualeti i gjykatës në Gjirokastrë, arrestohet 24-vjeçari

Saimir Ahmeti u kap pas 2 orësh, ishte fshehur në pus

Brikena Metaj

GJIROKASTËR


Një 24-vjeçar, i cili ishte arrestuar afro dy javë më parë nga policia e Sarandës është arratisur nga ambientet e Gjykatës së Apelit në Gjirokastrë, pak minuta para se të niste seanca gjyqësore. Bëhet fjalë për Saimir Ahmetin nga fshati Vanë i Delvinës, i akuzuar për "përndjekje". Mësohet se i riu ka kërkuar që të shkonte në tualet, por është arratisur. Pas sinjalizimit për ngjarjen, policia është vënë në ndjekje të 24-vjeçarit. Arratia ka zgjatur vetëm dy orë, pasi blutë bënë të mundur kapjen e tij në një pus në zonën e sipërme të Pazarit të Gjirokastrës ku ishte fshehur. Mësohet se gjatë momentit të arratisjes, Saimir Ahmeti ka pësuar shembje në trup, ndaj dhe pas arrestimit është marrë me ambulancë dhe është dërguar në spital për ndihmë mjekësore. Burime nga policia bënë me dije se 24-vjeçari ishte arrestuar në janar të këtij viti nga policia e Sarandës për përndjekjen e vazhdueshme dhe kërcënimin e bashkëjetueses së tij 18-vjeçare, Bleona Habibi, banuese po në fshatin Vanë të Delvinës. Mësohet se familja e vajzës nuk ka qenë dakord me lidhjen, ndonëse kjo e fundit prej 8 muajsh jetonte në shtëpinë e Saimirit. Pas arratisjes dhe vënies në pranga të 24-vjeçarit kanë reaguuar familjarët e të riut, të cilët deklaruan se nuk dinë që i biri i ta ketë dhunuar e kërcënuar ndonjëherë dhe se pretendimet e ngritura nga familja e vajzës janë të padrejta.

ARRATISJA

Rreth orës 11:50 të ditës së djeshme, i ndaluar Saimir Ahmeti ka mundur të largohet nga ambientet e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku ishte i shoqëruar nga shërbimet e policisë së Burgut të Sarandës. Shërbimet e Policisë së Burgjeve nuk kishin kërkuar masa mbështetëse nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë për siguri shtesë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.



Saimir Ahmeti me bashkëjetuesen 18-vjeçare, Bleona Habibi



24-vjeçari Ahmeti, pas nxjerrjes nga pusi

BABAI I TË ARRESTUARIT

I ati i Saimir Ahmetit dje u shpreh se djali i tij është i pafajshëm dhe se u arratis nga frika. Në një prononcim për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare", Thoma Ahmeti tha se djalin e akuzon ish-vjehrra, pasi nuk dëshiron të lidhet me vajzën e saj. Ai pohoi se policia do mbajë përgjegjësi nëse djali i ndodh ndonjë gjë. "Ne mezi e kemi rritur djalin. Atë e akuzon ish-vjehrra, sepse nuk do që të marrë vajzën e saj. Ne jemi familje e rregullt dhe ju mund të pyesni se çfarë familje jemi ne. Djali është i pafajshëm dhe ai u tremb nga frika, sepse është

akoma fëmijë dhe prandaj e bëri atë veprim duke u arratisur. Nuk e prisja të bënte këtë veprim. Unë do kërkoj edhe ndihmën e Avokatit të Popullit, sepse nëse im bir pëson gjë, atëherë policia do mbajë përgjegjësi", - deklaroi Thoma Ahmeti. Ndërkaq, psikologu u shpreh se 24-vjeçari është denoncuar se qëlloi me pëllëmbë të dashurën dhe i druhet frikës se ai mund të vrasë edhe veten si pasojë e shokut. "Djali u denoncua se qëlloi të dashurën me dy pëllëmbë. Ai ka kaluar në krizë nga ngjarja dhe kemi frikë se mund të pësojë ndonjë gjë", - tha psikologu.

Vendimi i Gjykatës së Sarandës

SARANDË - Në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Sarandës, dhënë më 26 janar të këtij viti thuhet: "Vlefshësin si të ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim Saimir Thoma Ahmeti, i kryer në datë 24.01.2018, ora 19:00, mbi bazën e urdhër ndalimit datë 24.01.2018, të prokurorit Ilir Hoxha, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'përndjekja' e ish-bashkëjetuesit apo personit që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 121/a të Kodit Penal. Të caktojë ndaj personit nën hetim, Saimir Thoma Ahmeti, masën e sigurimit personal (shtrenguese) 'arrest në burg', parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Urdhërohet policia gjyqësore të zbatojë këtë vendim. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, brenda 5 ditëve, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.



Policia e FNSH "blindon" Elbasanin, prangosen 8 persona me mina, armë dhe drogë

Tetë persona, pjesë e një grupi të rrezikshëm kriminal janë prangosur mbrëmë nga policia e Elbasanit. Mësohet se arrestimet janë bërë në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Forca të shumta policore të ndihmuar edhe nga Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH-ja) kanë "blinduar" qytetin për afro tri orë, ndërsa kanë arrestuar anëtarët e grupit kriminal, të cilët pohohet se janë nga Pogradeci dhe nga Gramshi. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se gjatë operacionit në fjalë janë sekuestruar armë, drogë dhe mina. Burimet e mësipërme pohuan se deri në orët e vona të natës janë kryer kontrollat edhe në banesat e personave të arrestuar. Operacioni që çoi në shkatërrimin e grupit kriminal u drejtua nga Altin Qato, ndërsa vijojnë hetimet për të vendosur para ligjit dhe persona të tjerë të lidhur me aktivitetin kriminal të bandës. Operacioni i mbrëmshëm erdhi pas takimit të kryeprokurorës Arta Marku me vartësit e saj në Elbasan. Gjatë këtij takimi, Marku kërkoi të hetohen grupet kriminale në këtë qytet.

INTERVISTA

Fatmira Nikolli

NERITAN LIÇAJ:

Grevë dhe bojkot të shfaqjeve kundër projektligjit të Kumbaros

Grevë dhe bojkot deri në ndalimin e projektligjit të Ministrisë së Kulturës për artin. Aktori Neritan Liçaj vjen në një reagim tejet të ashpër në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", sa i takon projektligjit më të ri që Ministria e Kulturës ka hartuar për artin. Pasi thekson se komuniteti artistik nuk është konsultuar dhe nuk i është marrë mendim, aktori i njohur, thotë se ligji i ri i jep shumë pushtet ministres dhe madje i ndalon artistët të kenë aktivitetet artistike pa marrë më herët leje në ministri, edhe në rastin kur financimi është tërësisht privat.

Ditën e martë, është mbledhur anëtarësia e gjashtë shoqatave kinematografike për të diskutuar lidhur me projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", si dhe projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e shkollës së lartë jopublike "Marubi...".

Sipas shoqatave, ligji "Për kinematografinë", i hartuar dhe miratuar, bazuar në eksperiencat më të mira evropiane, në vitin 1996, ka krijuar skemën më demokratike dhe bashkëkohore të prodhimit të veprave kinematografike, ndaj vlerësohet e papranueshme që sot, në vitin 2018 të bëhen hapa mbrrapa dhe të preket themeli i mekanizmit të funksionimit të kinematografisë shqiptare.

Nga ana tjetër, të martën, kinestet shqiptarë kundërshtuan në themel iniciativat e ndërmarra, pasi konstatojnë asgjësimin e parimeve bazë mbi të cilat funksionon kinematografia shqiptare. "Projektvendime të tilla minojnë skemën bazë me të cilën funksionon konkurrimi i lirë dhe përzgjedhja e projekteve - format, i miratuar gjerësisht nga kineastët, i cili gëzon mbështetjen e tyre më të gjerë. Komuniteti i kineastëve shqiptarë shpreh indinjatën legjitime për tentativat e vazhdueshme për të tjetërsuar formën juridike dhe buxhetin e QKK, në favor të interesave dhe të individëve të caktuar", thuhej në deklaratën e tyre.

Në intervistën e mëposhtme, Liçaj rendit arsyet pse është kundër ndryshimit.

- Pse jemi kundër projektligjit të ri të artit?

Nuk është puna se nuk jemi dakord të ndryshojmë ligjin, absolutisht jo. Unë jam një njeri që kam kërkuar të ndryshoj ligji dhe të bëhet statusi i artistit. Unë kam 15 vite që e kërkoj. Kërkoj që të bëhet një ligj i aplikueshëm. Ministria Kumbaro premtoi 6-mujorin e parë të mandatit të saj të parë, si ministere, të bënte ligjin për artin dhe statusin e artit. Kaloi mandati i saj i parë dhe nuk u bë asgjë. Ia kam kërkuar edhe përmes, mediave të ndryshme, që të mbajë premtimin.

Si duket pas katër vjetësh ministria paska bërë një ligj absurd, sepse ligji është qesharak, veçse i papranueshëm nga artistët.

Domethënë, ministria të emërojë gjithçka, as kryeministri të mos pyetet, për drejtorët e teatrove, për bordet e teatrove, për



Në foto: Aktori Neritan Liçaj në rolin e fundit, që do ketë së shpejti në Teatrin Kombëtar



Në fotomontazh: Neritan Liçaj dhe ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro

shfaqjet e për gjithçka. Ligji e përqendron të gjithë pushtetin në ministria dhe të ministria.

- Çfarë ndodh me këtë ndryshim? Ju hiqen të drejta?

Shkon deri në absurdin që, nëse unë dua të bëj një projekt privat, me financime komplet josh-tetërore, por tërësisht private, unë duhet të marr leje në ministri e kjo është absurde përveç faktit që i do të gjitha pushtetet vete ministria.

Ministria bashkë me kryeministrin, kanë bërë krimin e madh që kanë ndryshuar sistemin e punësimit të artistëve. Që të ndryshosh sistemin e punësimit në një sektor kaq të madh sa është arti duhet të

marrësh një vendim qeverie, nga gjithë ministrat. Ose një botim nga parlamenti.

Këta nuk e kanë bërë dhe ne tani kemi kontrata të paligjshme.

Po ta çojmë këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, ne i dërrmojmë ata.

Imagino që përpiqen t'ua heqin nëpunësve të vet. Harrojnë se ne jemi artistët e Shqipërisë, nuk jemi as të tij, as të Saliut, as të Lulit, as të Ilirit, të asqujt. Ne i shërbejmë kulturës së kombit. Kjo gjë, çështja nuk lihet me kaq. Reagimi ka për të qenë shumë i fortë, thjesht po i shkurtrojnë ditët vetes.

- Ndërsa hartohej ky projekt-

Aktori: Ministrja merr në duar disa pushtete, duhet të marrim leje tek ajo për çdo gjë

ligji, a janë konsultuar me ju?

Asnjëri, gjithmonë kështu ka qenë. Qeveria jonë dhe administrata e shtetit shqiptar në të gjitha nivelet, funksionon në rang CIA dhe kodesh bërthamore të Ushtrisë Amerikane. Nuk thonë asnjëherë asgjë, nuk informojnë për asgjë, nuk kërkojnë njëherë një mendim. Arrogance e tillë, unë nuk di ku mund të gjendet tjetër.

Dhe nuk është vetëm kjo, është sëmundje e politikës shqiptare, sapo kapin postin duan t'i kenë mbi vete të gjitha vendimet. Kështu bën edhe Kumbaro, që ngatëron amfiteatrin me teatrin dhe thotë Gëzuar Krishtlindjet në vend të Pashkëve.

- Ju kemi qenë në takimin e

teste, për shkak të asaj që po ndodhte në Teatrin e Kosovës. A është rasti që artistët shqiptarë të bëjnë të njëjtën gjë kundër këtij projektligji?

Të lësh shfaqjen në mes, goftë edhe për protestë shumë të denjë, pra për një protestë shumë të fortë, nuk është dënjtoze nga ana profesionale, sepse spektatori ka ardhur të të shohë dhe ka paguar biletën. Por, bojkoti është një gjë shumë e mirë dhe unë pikërisht këtë gjë do të nxis të kolegët, nuk e di sa do të më dëgjojnë. Bojkot ndaj këtij projektligji. Bojkot të punës, shpallim grevë se ne nuk pranojmë më asnjë lloj projektligji pa ardhur më para pa u konsultuar të ne. Do e propozoj të kolegët e mi, nuk e di sa do ia dalim, por unë vë bast se ministria do detyrohet të tërhiqet, sepse është tejet absurde. Nëse do të isha deputet i PS nuk do e votoja kurrë, nuk do e pranoja kurrë këtë ligj. As për vendim partie, sepse është absurd e qesharak. Edhe në kohën e Enverit ka pas pak më tepër liri artisti.

- Problemi kryesor i ligjit është që vendos ministria për çdo lloj gjëje?

Nuk është një ligj demokrat. Ka një handikap. Në Kushtetutë thuhet se "arti dhe kultura janë të depolitizuara". Ndërkohë që ne na vijnë ministra politikë, na vijnë drejtorë politikë, dhe të gjithë thejnë ligjin, bien ndesh me Kushtetutën. Fakti që ministria është politike, por mirë ajo, edhe drejtorët janë politikë, dhe ministria i merr në mbrojtje si rasti i Monika Lubonjës, që është qesharake vazhdon të mos e shkaktojë që të vijojë hetimi si duhet, kjo është situatë qesharake dhe e bën çdo gjë politike.

E kam shprehur publikisht se kjo bëhet që politika ta mbajë artistin të lidhur dhe të varur të buka e gojës, se në momentin që artisti del i pavarur, atëherë artisti kthehet në oponentin më të madh të politikës, siç ndodh në Amerikë, në Gjermani që janë artistët opozitarët më të mëdhenj të qeverive dhe politikave të gabuara. Kjo i tremb zotërinjtë e politikës, nën kontroll e nën diktat.

- Çfarë nënkuptoni me kontroll e diktat?

Që drejtoria e Teatrit Kombëtar të na kërkojë ne a kemi paguar ujin dhe dritat, ky është kulmi. Domethënë, drejtoria jonë e Teatrit Kombëtar me urdhër nga Ministria ose nga kryeministria, u kërkon aktorëve të Teatrit Kombëtar që të tregojnë, futurat e dritave. A ka më qesharake?

SAS?

Jo nuk kam qenë dhe nuk iki. Unë nuk futem të SAS, sepse kam zërin tim. E dyta, SAS është krijuar para zgjedhjeve, nga militantët partish, nga njerëz që erdhën në SAS pasi dolën nga çadra, nuk kam besim të SAS sepse është mekanizëm i manipuluar që do ta bëjë përfitime vetjake siç është bërë gjithmonë me sindikatat. Mbledhin njerëz që i ndjekin pas që kryetari të bëjë çfarë të dojë për vete e të mbrojë interesat e përfitimet e veta. Reagimi im, është qytetar, civil dhe artistik.

- Para një jave një aktor kosovar la shfaqjen në shenjë pro-

LUFTA ITALO-GREKE

Mbeti peng dilema dhe përgjigja e plotë për pyetjen se çfarë përfaqësuan Shqipëria dhe shqiptarët në luftën italo-greke: bashkëfajtorin apo viktimën?



Në foto: Duçja në Shqipëri

tare ndaj saj më shumë gjatë periudhës së "Luftës së Ftohtë" e më pak pas saj.

Kjo situatë konfliktuale që u krijua në marrëdhëniet shqiptaro-greke në 28 tetor 1940 dhe që sigurisht nuk ishte e para, këtë herë u nxit dhe u shkaktoi nga Italia fashiste që e mbante Shqipërinë të pushtuar që një vit e gjysmë më parë. Në Athinë e dinin mirë këtë fakt dhe Metaksai nga frika për ta mbajtur larg agresionin italian nga Greqia e kishte përgëzuar Musolinin për dërgimin e legioneve fashiste në Shqipëri. Mirëpo për një kohë të gjatë mbeti peng dilema dhe përgjigja e plotë për pyetjen se çfarë përfaqësuan Shqipëria dhe shqiptarët në luftën italo-greke: bashkëfajtorin apo viktimën?

Kupola kolaboracioniste shqiptare u tregua edhe më e lehtë se padronët e saj të Romës në gjykimin e rrethanave, faktorëve e forcave që do të përcaktonin fatin e luftës italo-greke. Ajo nuk ishte pjesë e analizës, e vendimmarrjes dhe e përcaktimit të taktikave e të strategjisë italiane të luftës. Anëtarët e kupolës fashiste shqiptare ishin thjeshtë dekoroi lakat i një "shëtitoreje lufte" që duhej të mbante dafkin që do të viheshin në kokat e gjeneralëve fitimtarë të perandorisë së re. Ata nuk e njohin e nuk e kuptonin shumicën e shqiptarëve që luftonin për ditë me varfërinë, me sëmundjet e që jetonin nën peshën e rëndë të hallevë të tyre. Mjafat shqiptarë shkuan në luftë si mercenarë, u rekrutuan kundrejt një pagese që iu premtua për ta çuar në fund të saj në shpëtim të tyre.

Italianët bënë çmos që t'i integronin plotësisht shqiptarët në luftën kundër Greqisë. Madje në mënyrë simbolike ishin dy batalione të Milicisë Fashiste Shqiptare që në mëngjesin e 28 tetorit sulmuan të parët kufijtë grekë në Epir. Por u zhgënjyren shumë shpejtë. Pritshmëria nga shqiptarët në frontin e luftimeve rezultoi nën zero. Dezertimi u bë një fenomen masiv dhe i organizuar. Të parët ngritën krye ushtarë e batalionit "Tomori" kur shumica e të cilëve në 4 nëntor u larguan nga fronti e ku mbetën vetëm 120 njerëz. Veprimi i tyre u pasua nga batalioni "Taraboshi" e pak më vonë edhe nga batalionet "Gramozi" e "Dajti". Vetëm në një natë, duke u gdhirë 23 nëntori, në zonën e Pogradecit dezertuan 206 ushtarë shqiptarë. Gjithësej në përfundim të luftës italo-greke dezertuan nga fronti e nga shërbimi mbi tre mijë shqiptarë.

Dezertimi i shqiptarëve në front e shtoi panikun që kishte zënë forcat italiane në vijën e parë të luftimeve, por edhe në prapavijë pas tërheqjes e humbjeve që kishin pësuar. Ishte më tepër një goditje morale se sa një prishje fatale në rreshtimin e forcave në front e një "tradhti shqiptare" që e përdorën gjeneralët fashistë italianë për t'u justifikuar për humbjet të Musolini.

Kriza e besimit që ekzistonte midis italianëve e shqiptarëve u thellua në ekstrem dhe po kështu edhe përbuzja e hierarkëve fashistë ndaj tyre. Fillori një reprezalje e "gjueti shtrigash" ndaj shqiptarëve që

PASKAL MILO:

Lufta italo-greke, fajtorë kuislingët miq të Musolinit e mercenarët shqiptarë

Historiani: Histeria fashiste nxori shqiptarët në luftë kundër Greqisë, shkuan edhe kundrejt pagesës

"Tre mijë shqiptarë dezertuan nga fronti, familjet e tyre u persekutuan dhe u internuan"

Fatmira Nikolli

Në 2 mars Musolini duke pilotuar vetë aeroplanin zbriti në aeroportin e Tiranës

SHQIPTARËT PËRKRAH GREKËVE

Edhe shqiptarët aq sa bënë në luftën italo-greke e bënë në radhë të parë për veten e tyre, për lirinë e vendit të tyre e pastaj edhe për grekët. Çështja për aq sa i bashkoi ishte lufta e përbashkët kundër një armiku të përbashkët.

Regjimi shqiptar nuk kishte legjitimitet për të folur e vendosur në emër të shqiptarëve. Asnjë institucion i tij nuk ishte i zgjedhur me votën e tyre e nuk mbështetej në themele demokratike përfaqësimi. Por kjo nuk e shmangu cilësimin e Shqipërisë si një vend armik e në gjendje lufte me Greqinë nga ana e autoriteteve greke kur ato, aktit të Mbretit të Italisë e të Shqipërisë, Viktor Emanuelit, e të ratifikuar nga qeveria e Shefqet Vërlacit, iu përgjigjen me një dekret analog lufte.

Në 10 nëntor 1940 në Greqi u shpall ligji i detyrueshëm Nr.2636 "Mbi veprimet juridike të armiqve dhe konfiskimin konservativ të pasurive armike". Po atë ditë u shpall edhe dekreti mbretëror "Mbi caktimin si shtete armike sipas kuptimit të ligjit të detyrueshëm Nr.2636/1940 të Italisë dhe Shqipërisë".

Në dekretin mbretëror shprehimisht thuhet: "Caktojmë si shtete armike, sipas kuptimit të ligjit të detyrueshëm të lartpërmendur, Italinë me dominionet, territoret perandorake dhe kolonitë e saj si dhe Shqipërinë. Vëmë në zbatim në tërësi dispozitat e ligjit në fjalë për sa u përket këtyre shteteve prej datës 28 tetor 1940". Ligji dhe dekreti mbretëror u botuan në Gazetën Zyrtare, 10 nëntor 1940, fashikulli A, faqe 379.

Kjo ishte ana formale e çështjes dhe që në kohën e shpalljes së tyre askush nuk kishte kohë të mendonte për rrjedhojat e ardhshme politike e juridike të këtyre akteve. Fjalën e kishin marrë armët e në varësi të rezultetit që do të sillte kryqëzimi i tyre do të gjykohej edhe ato. Qeveria kuislinge shqiptare i "dhuroi" popullit shqiptar një kokëçarje të pamerituar dhjetëra vjeçare prej të cilës nuk ka shpëtuar ende. Qeveritë greke me ndonjë përjashtim e shfrytëzuan thujtë po kaq vite këtë "gjendje lufte" me Shqipërinë për të ndërthurur bazën ligjore të pretendimeve territoriale ndaj jugut të vendit dhe të politikave zyr-

për të qenë i pranishëm e për të trimëruar forcat italiane në prag të shpërthimit të ofensivës. Vizitoi të gjithë frontin e luftimeve, Elbasanin, Gramshin, Beratin, Fierin, Vlorën, Llogoranë e deri në Dhërmi i shoqëruar nga gjeneralët, Çiano e hierarkët e lartë fashistë, Akile Starace e Roberto Fari-naçi. Ardha e Duçës në Shqipëri u mbajt e fshehtë jo vetëm për arsye sigurie, por edhe nga frika e një dështimi tjetër të turpshëm...Por, a ishin shqiptarët në këtë luftë, viktima a bashkëfajtorë?

Në këtë pjesë të dytë të materialit marrë nga libri "Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore" - I, botim i vitit 2014, i prof.dr Paskal Milo, trajtohet pozicioni i shqiptarëve në Luftën italo-greke dhe ardhja e Musolinit në Shqipëri për tri javë.

Milo, hedh dritë mbi kuislingët, mercenarët, miqtë e fashistëve duke përmendur emra si Terenc Toçi e jo vetëm si zë i fashistëve në Shqipëri. Historiani vëren se "Kriza e besimit që ekzistonte midis italianëve e shqiptarëve u thellua në ekstrem dhe po kështu edhe përbuzja e hierarkëve fashistë ndaj tyre. Fillori një reprezalje e 'gjueti shtrigash' ndaj shqiptarëve që dezertuan e ndaj familjarëve të tyre", pasi ka bërë me dije se 3 mijë shqiptarë të disa batalioneve ikën nga lufta.

VIKTIMA APO BASHKËFAJTORË?

Luftën kundër Greqisë Musolini e përgatiti, e shpalli dhe e bëri me gjithë bashkëpunëtorët e tij, kush më shumë e kush më pak. Ata ishin bashkëfajtorë për këtë agresion e për rrjedhojat që ajo solli. Të tillë njerëz kreu i fashizmit italian pati edhe në Shqipëri. Me ata ai krijoi regjimin e 7 prillit, qeverinë kolaboracioniste, partinë fashiste, Këshillin e Lartë Fashist Korporativ, të gjitha institucionet e një shteti kukull që i shërbeu fashizmit. Këta kishin një pushtet të deleguar nga Roma e të kontrolluar nga Mëkëmbësi i Përgjithshëm në Shqipëri, që zbatonin të gjitha urdhrat, dekretet e vendimet që vinin nga qendra e Imperos.


Kështu ndodhi kur iu shpall luftë Britanisë së Madhe e Francës në qershor e po i njëjti veprim u krye edhe në tetor 1940 kur nga territori shqiptar u sulmua Greqia. Kuislingët e të gjitha kategorive mbështetën luftën, brohoritën nëpër salla e ndër sheshe, nxitën mobilizimin civil e rekrutuan njerëz për t'i armatosur e për t'i dërguar në frontin e luftimeve. Kjo "aristokraci" e fashizmit në Shqipëri nuk ishte e madhe në numër, por ajo përdori të gjithë influencën personale, fisnore e krahinore, mekanizmat e shtetit, paranë e varfërinë për t'i joshur shqiptarët që t'i bashkoheshin luftës kundër



Në foto: Prof. dr. Paskal Milo

Greqisë. Përdori edhe kartën e nacionalizmit, "çlirimim" e Çamërisë me armët e fashizmit italian, për realizimin, siç shkruante kryetari i Këshillit të Lartë Fashist Korporativ, Terenc Toçi - Zenone Beninit, një "Shqipërie të madhe, me Perandorinë që do të bëjë më e gjerë dhe më e fuqishme".

Arkivat shqiptare kanë një numër të madh dokumentesh që dëshmojnë fare mirë këto përpjekje të kolaboracionizmit shqiptar të urdhëruar për të mobilizuar sa më shumë shqiptarë në frontin e luftës italo-greke. Një thujtë histeri fashiste e ushqyer edhe nga ndjenja të ndërsjella jo miqësore në kategori të caktuara sociale e zona gjeografike në të dy anët e kufirit, bëri që mijëra shqiptarë të rreshtoheshin në anën e agresorëve. Por ishin pak në krahasim me shumicën e shqiptarëve që, ose qëndruan indiferentë ose e kundërshtuan luftën.



Në foto: Imazhe të luftës italo-greke në Shqipëri



dezertuan e ndaj familjarëve të tyre. Ushtarët dezertorë që u kapën dhe mbeturinat e batalioneve shqiptare u grumbulluan në fillim në Fier e pastaj në Shijak ku edhe u riorrganizuan në një grupim të vetëm të quajtur "Skanderbeg". Me mijëra urdhra arresti (ordine di cattura) u dhanë për ushtarët dezertorë gjatë gjithë kohës që vazhdoi lufta italo-greke e pas saj nga Gjykata Ushtarake e Luftës. Me qindra familje të ushtarëve të dezertuar ose të arratisur u persekutuan dhe u internuan, përfshirë edhe afro 400 veta në Itali.

Avancimi i forcave greke në Shqipërinë e Jugut ringjalli projektin e vjetër të pretendimeve të Athinës për aneksimin e këtij territori të shtetit shqiptar. Metaksai foli për çlirimin e Shqipërisë nga fashizmi italian por edhe nënvizoi me theks të veçantë nevojën e zotërimit të disa pikave strategjike në vend për të mbrojtur Greqinë nga ndonjë agresion tjetër.

Deklaratat e Metaksait ishin me mesazhe krejt të qarta: jo Shqipëri të pavarur dhe jo integritet territorial të saj në të ardhmen. Ato i kapën mirë e i shfrytëzuan në Romë e në Tiranë për t'u bërë thirrje të tjera shqiptarëve për t'u bashkuar në luftën kundër Greqisë. Ato u interceptuan e u komentuan edhe në Londër. Në Forin Ofis referuar deklaratës së gjeneralit Metaksa se Greqia ishte duke luftuar për lirinë e Shqipërisë shprehën bindje se asnjë grek nuk i jepte rëndësinë më të vogël asaj dhe askush nuk ishte gati "të derdhte gjakun e tij për lirinë e shqiptarëve". Edhe sikur ai të ishte gati, shkruante Pirson Dixon (Pierson Dixon), "të na thotë në se ai shpreson për një Shqipëri të pavarur pas luftës, është e dyshimtë nëse ai do të dëshiron që kjo të shpallej publikisht". Dhe Metaksai si për të mos i lënë më tej britanikët që të hamendësonin rreth qëndrimeve të tij, ua bëri të qartë se ai nuk do të mbështeste restaurimin e një Shqipërie të pavarur.

Edhe shqiptarët aq sa bënë në luftën italo-greke e bënë në radhë të parë për veten e tyre, për lirinë e vendit të tyre e pastaj edhe për grekët. Çështja për aq sa i bashkoi ishte lufta e përbashkët kundër një armiku të përbashkët.

Qeveria greke nuk e kishte pritur që agresioni fashist italian kundër Greqisë do të krijonte rrethana të favorshme për të ringjallur çështjen e "Vorio Epirit". Rasti u paraqiti dhe ajo vendosi ta shfrytëzojë, një rrugë e dy punë, vazhdimi në thellësi të territoreve shqiptare të luftimeve ndaj forcave të organizuara italiane me objektivin madhor për të dalë në Vlorë e në Durrës dhe vendosjen e konsolidimin e administratës së re ushtarake greke, të paktën deri në vijën: liqeni i Ohrit-Vlorë. Siç po zhvilloheshin ngjarjet kjo perspektivë në dimrin e 1940-41 duke shpresëdhënëse jo vetëm në Athinë, por edhe në Londër.

Në dritën e këtyre zhvillimeve qeveria greke nuk e ndjente shumë të nevojshme një rezistençë antiitaliane nga shqiptarët në Sh-

“ Arkivat shqiptare kanë një numër të madh dokumentesh, që dëshmojnë fare mirë këto përpjekje të kolaboracionizmit shqiptar të urdhëruar për të mobilizuar sa më shumë shqiptarë në frontin e luftës italo-greke.

qipëri, por edhe jashtë saj pa qenë nën kontrollin e brenda objektivave të saj. Është kjo arsyeja që ajo nuk ra dakord as edhe me skemën e organizimit të një kryengritjeje në Shqipërinë e Veriut nën udhëheqjen e Mbretit Zog ose të Gani Kryeziut që u shpërndau në Forin Ofis për disa muaj reshë e në funksion edhe të ndihmës për Greqinë në prapavijata italiane. Metaksai donte ta mbante në një profil sa më të ulët rezistencën shqiptare ndaj edhe e kundërshtoi projektin e kryengritjes e pranoi vetëm përdorimin e bandave të vogla e të mirorganizuara guerile shqiptare në prapavijata italiane.

Lufta italo-greke u zhvillua thaujse në territorin shqiptar për rreth gjashtë muaj. Për një luftë që ishte e huaj për ta, shqiptarët paguan shtrenjtë. Më shumë se sa u vranë e u plagosën njerëz, u dogjën e u shkatërruan fshatra të tëra, shtëpi e prona të mijëra familjeve, rrugë e urra. U shpërngulën me detyrim nga zona e luftimeve e shumë të tjerë për arsye sigurie në zona më në brendësi të vendit, një numër njerëzish që arriti rreth 19 mijë



vetë. Atyre u jepej një "ndihmë" ditore që shkonte nga 1-2 franga për një familje me një anëtar deri 7-8 franga për familje me mbi shtatë persona.

Për një vend të varfër si Shqipëria, dëmton që solli lufta ishin një hipotekë e rëndë për dhjetëra mijëra njerëz. Mëkëmbësia e qeveria Vërlaci nxorën vendime për llogaritjen e dëmeve të luftës, të cilat asnjëherë nuk u bënë të njohura plotësisht. Veç u parashikua që për vitin buxhetor 1941-1942 qeverisë t'i jepeshin 30 milion lireta si kontribut i jashtëzakonshëm për të mbuluar shpenzimet e bëra gjatë luftës italo-greke. Në thesin e qeverisë për dëmshpërbimim e luftës "kontribut" edhe Mbreti Viktor Emanueli me një

milion lireta kur erdhi në maj 1941 për vizitë në Shqipëri.

Masat e pjesshme nuk e përmirësuan imazhin e italianëve e të regjimit kuizling në sytë e shqiptarëve, as edhe vetë pozitën e tyre ushtarake në frontin e luftimeve. Dimri kishte ulur ritmin e veprimeve ushtarake të të dy palëve, të cilat prisnin veç pranverën për të bërë betejën e tyre përfundimtare.

MUSOLINI, TRI JAVË NË SHQIPËRI

Ndërkohë që forcat italiane e greke luftonin midis tyre në kushtet e një dimri të egër në shpatet e maleve të Trebeshinës, të Shëndëllisë e të Golikut për të zotëruar luginat e Vjosës, Drinos e Devollit prej nga do të varej edhe fati i Tepelenës, Vlorës e Beratit, në Romë e në Athinë po hartoheshin planet e betejës finale. Në frontin juglindor italianët po rezistonin në vijën mbrojtëse për të mos lejuar kontrollin e brigjeve jugore e perëndimor të liqenit të Ohrit nga grekët prej nga hapej rruga për të pushtuar Elbasanin.

Musolini ishte i rënë moralisht në dimrin e vitit 1940-41 për dy arsye: e para, se ai nuk e kishte menduar kurrë që divizionet italiane do të mundeshin aq keq në fushën e betejave me forcat greke; e dyta, se "prestigji ushtarak italian" kishte marrë një goditje të rëndë, veçanërisht në sytë e aleatit të tij, Hitlerit. Që në fillim të janarit 1941, Duçë urdhëroi Kavalieron që të përgatiste planin e sulmit, aksion "që duhet të iniciohet e të vazhdohet me një energji ekstreme" dhe që "e bën të panevojshme ndihmën direkte të Gjermanisë në frontin shqiptar". Jo vetëm në planin moral, por edhe në funksion të synimeve tashmë të njohura italiane në Ballkan, Musolini nxitoi të përgatitej për një ofensivë në pranverë, konkretisht në mars kundër ushtrisë greke në frontin shqiptar. Ai ishte njohur nga vetë Hitleri për operacionin e ardhshëm gjerman për pushtimin e Greqisë dhe dëshironte që para tij të dëshmonte fitoren e armëve italiane ndaj këtij vendi që do të lejonte që të ulet si i barabartë në ndarjen e trofeut të luftës. Në dhjetëditëshin e fundit të shkurtit i njoftoi Fyhrerin për këto përgatitje. Në Berlin e dinin "se Komanda e Lartë Italiane kërkon ta mund ushtrinë greke para se të arrihet një kompromis paqeje".

Athina ishte në dijeni të synimeve italiane dhe po përgatiste ofensivën e vetë, qëllimi kryesor i të cilës ishte t'i hidhte italianët në det. Në fund të shkurtit, Kavalero po përgatiste "ofensivën e Musolitit, dhe Papagos dëshiron të vazhdonte ofensivën e Papagosit". Ndërkohë në 29 janar Metaksai kishte vdekur dhe kryeministri i ri grek, A. Koricis nuk e kishte autoritetin e paraardhësit të vet. Ushtria greke pavarësisht nga epërsia e përkohshme në terren e me moral të ngritur, përsëri, me gjithë mbështetjen angleze ishte e dëmtuar dhe vështirë se mund të mbante iniciativën në frontin e luftimeve për një kohë të gjatë. Në Komandën e Lartë të ushtrisë greke pati dilema. Komandantë të forcave greke në frontin e luftimeve kërkuar më tepër kohë në përgatitjen e ofensivës dhe kundërshtuan planin e Papagosit. Ata u shkarkuan nga pozitat drejtuese në ushtrinë greke në Epir, që dha shkas për një rior-



ganizim të zinxhirit komandues ushtarak grek në prag të ofensivës së pranverës.

Beteja e pritshme italo-greke do të ishte vendimtare për fatin e luftës. Në 2 mars Musolini duke pilotuar vetë aeroplanin zbriti në aeroportin e Tiranës për të qenë i pranishëm e për të trimëruar forcat italiane në prag të shpërthimit të ofensivës. Vizitoi të gjithë frontin e luftimeve, Elbasanin, Gramshin, Beratit, Fierin, Vlorën, Llogoranën e deri në Dhërmi i shoqëruar nga gjeneralët, Çiano e hierarkët e lartë fashistë, Akile Starace e Roberto Farinaci. Ardhja e Duçës në Shqipëri u mbajti e fshehtë jo vetëm për arsye sigurie, por edhe nga frika e një dështimi tjetër të turpshëm. Opinioni publik italian vetëm pas dy muajsh, në maj u informua zyrtarisht për qëndrimin afro tre javor të Musolitit në Shqipëri. Me ditë të tëra ai qëndroi në zonën Rehovë-Dhëmban.

Më 9 mars, kur filloi ofensiva e forcave italiane në drejtim të Këlcyrës, Musolini ishte në pikën e vëzhgimit në Komarit (në Glavë), në një lartësi 800 m mbi nivelin e detit, në front së bashku me Kavalieron dhe ushtarakët të tjerë të lartë italianë. Qëndroi aty tre ditë pa lëvizur duke ndjekur nga afër luftimet e duke dhënë urdhra. I ndërgjegjshëm për rëndësinë e kësaj ofensive u deklaroi gjeneralëve që e rrethonin se "është absolutisht e nevojshme një fitore ushtarake për prestigjin e ushtrisë italiane deri në fund të muajit".

Gati një javë ushtrinë greke dhe italiane u ndeshën në një luftë të egër, me avancime të tjerë të vogla, por me humbje shumë të mëdha njerëzore nga të dyja palët. Musolini donte me çdo çmim të mbahej Tepelena dhe me çdo çmim të fitohej Këlcyra. Simboli i kasaphanës u bë lartësia 731 ose vendi i quajtur Manastir. U derdh shumë urrejtje e shumë gjak në këtë vend nga të dy ushtritë. Lartësia kalonte nga njëra dorë në tjetrën në një luftë që ishte e qeverive të tyre por jo domosdoshmërisht e njerëzve të mobilizuar e aq më tepër në vend të huaj.

Musolini mbeti më i zhgënjyer se sa kishte qenë më parë nga gjeneralët e ushtrimë e tij. Jo për herë të parë foli me përbuzje për popullin e tij. Në Shqipëri desh pësoi dramën e dytë familjare. Pas humbjes së djalit në luftën afrikane, gati sa nuk humbi dhe vajzën Edda, gruan e Çianos kur si anija spitalore "Po" në të cilën ajo shërbente si infermiera e Kryqit të Kuq, u mbyt në ujërat në afërsi të portit të Vlorës, e bombarduar nga gjuajtës anglezë. Musolini u kthye në Vlorë për të vizituar të bijën në 15 mars dhe pasi inspektoi edhe njëherë tjetër frontin e luftimeve, në 21 mars u largua nga Shqipëria. Vështirë se ky vend mund të ishte më "në zemrën e tij" siç kishte deklaruar me patetizëm kur ai u pushtua në prill 1939. Shqipëria u bë ferri i ushtrisë italiane, por edhe fronti ku Musolini u turpërua së bashku me strategjinë e tij të luftës. Sapo u ul në Romë me aeroplanin e tij shpërtheu si jo rrallë herë me zemërim e i rënë moralisht: "Jam i pështirosur nga ky ambient. Nuk kemi avancuar asnjë hap. Më kanë gënjyer deri sot. I përçmoj thellësisht të gjithë këta njerëz".

Dështimi i ofensivës pranverore shënoi edhe fundin e operacioneve ushtarake në stil të gjerë në frontin italo-grek të luftimeve. Forcat italiane u pozicionuan në mbrojtje, ndërkohë që Papagos vazhdonte të mbante iniciativën duke kryer sulme të vazhdueshme me objektiv kryesor pushtimin e Tepelenës. Kjo situatë vazhdoi deri në ditët e para të prillit.

Lufta italo-greke la gjurmë të thella në marrëdhëniet midis vendeve ndërluftuese, por edhe rrjedhoja shumë të rënda për Shqipërinë e jugut që u kthye në një shesh lufte midis ushtrive të tyre. Të dy shtetet patën humbje të mëdha njerëzore e materiale, pavarësisht se shifrat që kanë dhënë në atë kohë palët ndërluftuese mund edhe të mos përputhen. Në përfundim të kësaj lufte Sh-tabi Madhor i ushtrisë italiane raportoi se ishin vrarë afro 14 mijë njerëz, ishin plagosur rreth 51 mijë të tjerë dhe llogariteshin të humbur mbi 25 mijë vetë. Më vonë këto shifra patën një korigjim të vogël. Humbjet e ushtrisë greke sipas burimeve greke ishin: 11 mijë e 911 oficerë dhe ushtarë të vrarë e të vdekur dhe 1342 të humbur.

Opinion i Ditës

Jo më me këto 10 argumente

Nga Dr. Jorgji KOTE

(Vijon nga faqja e parë)

... cilësore përshpejtimin të anëtarësimit dhe më konkretisht të çeljes së negociatave tona me BE.

Ndaj, të paktën deri në muajin prill kur do të publikohet Progres Raporti i Komisionit Evropian për secilin vend dhe në maj kur do të mbledhet samiti i posaçëm kushtuar Ballkanit në Sofje kërkohen hapa dhe rezultate të tjera të matshme, sidomos në fushën e reformës gjyqësore; nuk po zgjatemi në këtë pikë që është nënvizuar në shkrimin e datës 12 nëntor 2017 në këtë gazetë "Prapë hapa, pastaj data" dhe atë të datës 10 dhjetor 2017 "Negociatat, topi ende në fushën tonë".

Por këtu do të theksojmë se krahas të tjerash, Strategjia e re e zgjerimit i ka bërë jo vetëm të pakëshillueshme, por dhe të pavlefshme disa deklaratime, pohime dhe pretendime ndaj BE-së dhe vendeve të caktuara anëtare.

Nisur dhe nga përvoja sidomos gjatë 20 viteve të kaluara si diplomat i përfshirë në këtë proces në Tiranë, Berlin dhe në Bruksel deri muajt e fundit, më poshtë, po i paraqes në mënyrë fare të përmblodhur këto 10 "don'ts" ose gjëra që nuk duhen bërë/përmendur më, sidomos në publik. Po i rendisim pa shumë teori, në formë të thjeshtë dhe nga pikëpamja e real-politikës, d.m.th. si funksionojnë gjërat realisht dhe jo thjesht sipas vullnetit/dëshirës së mirë ose "wishful thinking" siç thuhet në anglisht.

"BE është fajtoare për vonesat, mosarritjet dhe dështimet tona", madje duke e shoqëruar këtë pretendim dhe me terma të papërshtatshëm referues ndaj saj. Kjo sepse, pa përjashtuar gjynahet e saj në drejtime të tjera, por dhe krizat e shumta e serioze gjatë këtyre viteve, institucionet e BE-së dhe vendet e saj anëtare do të na tregojnë plot faktë lidhur me ndihmën dhe mbështetjen e dhënë për çeljen e negociatave nga Samiti i Selanikut e deri më sot.

Do të na rikujtojnë, gjithashtu, me të drejtë se ka qenë politika jonë, sëmundjet tashmë të vjetra të korrupsionit, krimin të organizuar, dobësinë në drejtim të shtetit të së drejtës, mungesat e dialogut me opozitën, bojkotet parlamentare, rebelimet e dhunshme të rrugës dhe krizat e vazhdueshme që 1996, 1997, 1998, 2003, 2010 dhe 2017 që kanë shkaktuar këto vonesa të pajustificueshme.

"Ne i kemi kryer detyrat e shpësit dhe reformat e kërkuara, përfshirë dhe vetingun, kështu që negociatat duhet të çelen një orë e më parë".

Ky pohim i palës sonë që qëndron në një masë të madhe gjithësesi nuk mjafton dhe nuk bind, sepse rëndësi vendimtare këtu ka mendimi dhe perceptimi i institucioneve evropiane dhe i të 27 vendeve anëtare, deri te Malta dhe Luksemburgu i vogël; veç kësaj, strategjia e re thekson qartazi mosarritjet, dështimet dhe nevojën e zbatimit praktik të reformave.



Ndaj, sugjerohet që gjuha që do përdorur nga ana jonë të jetë pak a shumë: "ja ku jemi, kemi bërë këto dhe ato, tani na gjykoni ju!".

"Ja, të gjitha vendet janë dakord që të çelen negociatat, me përjashtim të ndonjë apo dy shteteve!

Më të tilla pohime jo vetëm nuk do të arrijmë dot të "përplasim" ndërmjet tyre vendet anëtare dhe institucionet e BE-së, por mund të bëhemi të pabesueshëm të partnerët tanë, si ata që na mbështesin dhe ata që ende jo. Tani, vërtet në turet e ministrit të Jashtëm, zotit Bushati tejet aktiv përmendet se homologët që ai apo dhe kryeministri takon na mbështesin: por kujdes se këtu fjala është në përgjithësi. Sa për çeljen e negociatave, pohimet e tyre mbështetëse nuk kanë ndonjë efekt konkret, sepse duhet që më parë të shprehet zyrtarisht Komisioni Evropian, gjë që ende nuk është bërë.

"Dakord, por korrupsion dhe krim të organizuar ka dhe në vendet anëtare të BE-së, përse atëherë penalizohemi vetëm ne?"

Është pretendim pa dobi, sepse e para ne jemi vend kandidat dhe as nga ana etike nuk shkon që të ngremë pretendime dhe të qortojmë BE-në ku kërkohet të hyjmë. Së dyti, po, fakti i mësipërm qëndron deri në një farë mase; mirëpo vendet anëtare kanë traditë, institucione të konsoliduara dhe strukturat e tyre të specializuara të kontrollit dhe vëzhgimit në këtë fushë që ende nuk i kemi. Së treti, duke na dhënë të drejtë për këto vërejtje, mund fare mirë të na thonë, siç ka ndodhur në disa raste të "e po mirë atëherë, meqë qenka kështu puna, prisni sa ta luftojmë

korrupsionin në vendet tona dhe pastaj "ju pranojmë ju!".

"Po Rumania dhe Bullgaria pse u pranuan atëherë me gjithë ato probleme të ngjashme?"

Në fakt, ky veprim i BE-së me këto dy vende i nxitir nga nevojat politike dhe gjendja ndërkomëtare e asaj periudhe është qortuar në disa vende anëtare të BE-së. Të njëjtin "gabim" bëri BE-ja dhe kur pranoi Kroacinë duke i besuar premtimit të saj, por që nuk e mbajti për zgjidhjen e një problemi territori me Sloveninë fqinjë fill pas anëtarësimit të saj më 2013. Ndaj, sërish, fare mirë do të na thonë "e po mirë, meqenëse gabuam me këto dy vende, nuk po ju pranojmë dhe ju pa plotësuar kushtet

"Po Serbia dhe Mali i Zi pse po ecin më përpara, aq më tepër kur ata anojnë dhe nga karrigia e Moskës? Pse standarde të dyfishta dhe jo si grup në rajonin tonë?"

Edhe ky argument është irrelevant, sepse dhe Strategjia e re e zgjerimit e ka bërë fare të qartë se Serbia dhe Mali i Zi i kanë plotësuar disa vite më parë kushtet dhe kërkesat e caktuara; ndaj dhe i kanë çelur bisedimet me kohë. Natyrisht Serbia do ta ketë problem kur të vijë puna për anëtarësimin e plotë me kushtin e njohjes së Kosovës, por ajo është histori tjetër.

Ndaj, nuk ka standarde të dyfishta kurrsë. BE dëshiron që Ballkani Perëndimor të hyjë pa vonesa të tjera dhe si rajon në BE, tashmë ka dhënë dhe një datë indikative, por jo detyruese, duke e shoqëruar këtë detyrimishtë dhe me plotësimin e kryerive të mer-

itës në secilin vend.

"Negociatat me Shqipërinë dhe rajonin duhet të çelen për shkak të aspektit gjeostrategjik në rajonin tonë. Sërish, strategjia e re i ka dhënë përgjigje përfundimtare kësaj sfide; duke ofruar dhe data treguese për një të ardhme të afërt, BE e ka thënë me gojë plot se Ballkani Perëndimor i përket BE-së. Ky mesazh është pikërisht për Rusinë, Turqinë dhe Kinën. Nga ana tjetër, BE nuk mund të tolerojë më që në emër të interesave gjeostrategjike, me gjithë rëndësinë e pamohueshme që ka gjeostrategjia të "importojë" dukuri dhe fenomene të tjera negative, se boll ka prej tyre dhe tani.

"Po nuk na pranuan tani në BE, kemi alternativa të tjera!"

Përgjigja nga BE u dha po në këtë strategji, kur nënvizohet se anëtarësimi në BE është çështje zgjedhjeje. Pastaj, kurrkush nuk i lut Shqipërisë që të aderojë në BE, ishim ne me endrën e dhjetorit 1990 që kemi 27 vite që e bëjmë këtë lutje dhe BE na mirëpret, se dhe ajo ka interesat e veta të shoqëruara përherë me kërkesa të ligjshme. Por, në rast se kemi variante të tjera, atëherë ku shkuan përbitimet tona se alternativa e vetme është integrimi në BE? Sa të besueshëm do të bëhemi për elektoratin tonë dhe sidomos për BE-në dhe partnerët tanë ndërkomëtarë?

Ne nuk po kërkohet anëtarësim por thjesht çeljen e negociatave. "Po, por ka kritere dhe rregulla dhe për këtë etapë madhore politike, ekonomike dhe teknike, ndoshta dhe më të forta se anëtarësimi. Sepse vetëm me plotë-

simin e kushteve dhe kërkesave të njohura negociatat do të ecin rrjedhshëm, pa probleme dhe pengesa në të gjitha fushat dhe do të përfundojnë brenda afateve optimale pa u shtyrë në kalendrat greke.

Ndaj kërret e BE-së theksuan se nuk do të ketë anëtarësim automatik pa kaluar në "sitën" e kërkesave të saj deri në ratifikimin nga të 27 vendet anëtare, ndaj është shumë herët të flasim për të.

"Lodhja nga pritja dhe mosdurimi i njerëzve do të jetë me pasoja të rënda për BE dhe rajonin ". Po, BE është e ndërgjegjshme për këtë pretendim në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, ndaj dhe shpalli Strategjinë e re që do të pasohet nga Samiti i posaçëm në maj në Sofje; ndërkohë, BE është po aq ndërgjegjshme, siç duhet të jemi dhe ne për lodhjen, drojën dhe skepticizmin nga zgjerimi i mëtejshëm të paktën në shumicën e 27 vendeve të BE-së. Sidomos në këto vitet e fundit dhe pas krizës së azilit ku vendet e rajonit tonë, le ta themi, se po "kontribuojnë" jo pak. Kjo po vërehet dhe këto ditë, kur në median e disa vendeve, përfshirë dhe atë gjermane krahas komenteve pozitive, zgjerimi i mëtejshëm drejt Ballkanit Perëndimor konsiderohet si një " shaka e hidhur".

Veç kësaj, pretendimin e lartpërmendur e "tradhtojnë" sondazhet që tregojnë se me gjithë vonesat e mëdha, shumica dërmuese e popullit shqiptar mbetet sërish në favor të anëtarësimit në BE, më shumë se në çdo vend tjetër. Ndaj nuk mund të bindim e ca më pak të " kërcënojmë " kërkënd në Evropë me këtë argument bumerang.

"Nuk do opozita, po pengon ajo"

BE e ka dhënë me kohë përgjigjen duke theksuar se "kjo është puna juaj; ndaj zgjidhni problemet mes jush, sipas vlerave evropiane, me dialog të vazhdueshëm, konsensus, tolerancë dhe lëshime. Mbi të gjitha duke e shpallur dhe realizuar në praktikë anëtarësimin në BE si TOP temën strategjike. Do të na tregojnë dhe që megjithëse në Estoni dhe në Kroaci nga viti 1991 janë ndryshuar shumë qeveri, askush nuk ka devijuar nga anëtarësimi i shpejtë në BE. Për të mos shkuar te Belgjika që në vitet 2007-2011 pati disa kriza të rënda qeveritare dhe institucionale, por sërish kryesoi me shumë sukses dhe bindshëm BE, OSBE dhe Këshillin e Evropës. Jo për ndonjë çudi, por, sepse për politikën e saj të jashtme, dhe sidomos për çështjet evropiane pozita dhe opozita, shoqëria civile, të gjithë ishin në unison të plotë.

Kësisoj, duke i hequr këto 10 (jo) argumente nga fjalori ynë politik në komunikimet me partnerët evropianë, duke shtuar arritjet dhe rezultatet konkrete në zbatimin e reformave mbi bazën e përparimeve jo të pakta gjatë këtyre muajve të mbetur, janë mundësitë për çeljen e negociatave qysh këtë vit, si një domosdoshmëri strategjike.

Sa për diplomacinë, është fakt i vlerësuar dhe nga partnerët që drejtoritë përkatëse në MPJ dhe sidomos Misioni ynë pranë BE-së në Bruksel kanë bërë maksimumin me kapacitetet dhe përkushtimin e tij profesional dhe qytetar; tashmë i mbetet politikës që ta thotë më mirë fjalën e saj me rezultatet të preksheve për të gjithë.

Dje në 'Deutsche Welle'

VOLKER WAGENER

BE-ja do të bëhet vërtet ballkanike tani!

(Vijon nga faqja e parë)

... prej të marri, mendon Volker Wagener.

Kjo quhet një dilemë e vërtetë. Objektivist, gjashtë kandidatët evropianë në dhomën e pritjes së BE-së janë aq larg nga standardet e Brukselit, sa edhe një motor gjerman me naftë prej kufijve të gazrave. Por, që të presësh deri sa mini dhe mikro-shtetet e Ballkanit të plotësojnë normat e BE-së, kjo

shkruan sot Komisioni - Serbia dhe Mali i Zi duhet të jenë kompatible me BE-në deri në vitin 2025". Një dëshirë e përkorë, nëse jo një naive.

Fakt është që po ta shohësh ditën, Ballkani Perëndimor është në pothuajse çdo aspekt një çmenduri, të paktën nga perspektiva e Brukselit. Marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën i ngjajnë një lufte të ftohtë. Në Republikën Srbska, Beogradi ndërhyr thuhet shesht,

çitet e demokracisë, për burokratët e BE-së, që mbushin me kujdes formularë dhe përsërisin kritika rituale. Kina bën fakte të kryera. Ndërton ura dhe kombinat çeliku në Serbi, aeroportet në Shqipëri, fabrika makinash në Hungari dhe porte në Greqi. Si shpërblim për investime të tilla që zbatohen me shpejtësi, Pekini kërkon më shumë se një falënderim të singërt, ai pret mirënjohje politike. Me pak fjalë, huat për dhe projektet e

e BE-së. Kina sheh në Evropën Lindore dhe Juglindore një stacion manovrimi për Rugën e saj të re të Mëndafshit. Kjo nuk mund të jetë në interes të evropianëve. Por, përpjekjet integruese të BE-së për fqinjët e saj të këqij nga Evropa Juglindore po bëhen në mes të krizës. Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakët kanë formuar prej shumë kohësh brenda BE-së një grup kundër Brukselit. Ata kanë gjithashtu rritje të fortë



do të ishte një dhoratë për kinezët. Ata nuk pyesin për sundimin e ligjit dhe nuk i bezdis korrupsionin. Ata investojnë dhe japin kredi në Ballkan, i cili për Evropën Perëndimore është i ndotur madje që në emër.

I GJITHË RAJONI, FUÇI BARUTI

Edhe vetë fakti që "kinezët" kanë arritur tashmë në Ballkan, shpjegon se pse BE heq dorë nga itinerari i saj i mëparshëm. Sepse pas pranimit të nxituar të Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2007, ajo premtoi të mos zgjerohet në të ardhmen në gjerësi, por në thellësi. Së pari, duhet të forcohen marrëdhëniet me anëtarët e rinj të Lindjes. Ky tenor tani me sa duket është harruar: "Me vullnet të fortë politik për zbatimin e reformave -

duke destabilizuar një shtet që është më i brishti në rajon, Bosnje dhe Hercegovinën. Maqedonia po grindet me Greqinë për emrin dhe në pothuajse të gjitha republikat e Ballkanit, nacionalizmi dhe korrupsioni lulëzojnë. Dhe pikërisht aty BE-ja dëshiron që brenda pak vitesh të valëvitet flamuri evropian. Mjaft e guximshme kjo!

KINA JEP KREDI DHE NDËRTON, BE-ja SHTRON KËRKESA

Por, BE-ja duhet ta bëjë këtë, sepse nëse fëmijët "e këqij" në periferi të Evropës nuk do të bëhen anëtarë të firmës së Brukselit, ata ndoshta do të shkojnë së shpejti në një drejtim tjetër. Në Lindje domethënë. Madje, drejt Lindjes së Largët.

Kina nuk bën kërkesa për sundimin e ligjit, buzëqesh për defi-

ndërtimit në anën lindore të BE-së, përfshirë edhe shtetet e ardhshme anëtarë po i mundësojnë Pekinit të qeverisë në BE që tani.

Ndikimi politik është tashmë i dukshëm. Në shtetet e Vishegradit, stili autoritar i Pekinit vlerësohet. Pekini nuk jep mësim dhe udhëzime në adresë të Pragës ose të Budapestit siç bën Brukseli. Nga pikëpamja e marrëveshjes, logaria është mjaft e thjeshtë, Kina jep shpejt dhe pa parakushte demokratike, ajo krijon fakte. Brukseli nga ana tjetër është shumë i ngadalshëm dhe sille si mësuës.

BE, NË KËRKIM TË PERSPEKTIVAVE NË MES TË KRIZËS

Prandaj, Komisioni i Brukselit ka arsye të mira për t'u frikësuar nga angazhimi i Kinës në oborrin

ekonomike, gjë që nuk mund të thuhet për vendet e reja në jug. Integrimi, megjithatë, ka të bëjë shumë me konvergencën ekonomike. "Projekti gjashtë anëtarë të rinj të familjes së BE-së" pra mbetet një iluzion për momentin.

Po ashtu, ndryshime nuk do të ketë edhe pse Brukseli përmend vazhdimisht demokracinë apo sundimin e ligjit. Në Perëndim shpesh harrohet se në ato vende janë ende në pika të rëndësishme në pushtet breza që janë rritur në komunizëm. Siç e dimë, ai u zëvendësua nga një epokë nacionalizmi, e cila në përgjithësi është ende shumë përcaktuese. BE-ja e vjetër dhe BE-ja e re sigurosh që janë një e përbashkët, por ato thjesht ende nuk përshatën me njëra-tjetrën.

HOROSKOPI

DASHI

Nën tërheqjen e Venusit dhe Marsit, Hëna iu prish disi qetësinë dhe krijon pengesa në rrugë tashmë të gjatë. Do të merreni të promovoni një projektin tuaj të punës, tek i cili keni shumë pritshmëri. Gjasat janë që të dalë me sukses.

DEMI

Nëse me partnerin është krijuar pak tension, mos e vononi çështjen për ta sqaruar. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni! Përfitoni nga mbështetja që ju garanton familja, për të përbushur zgjedhjet që do të bëni.

BINJAKET

Rruga e gabuar dhe vonesat mund të bëjnë që të dështojë një plan. Por mos u dekurajoni, pasi keni mundësi të gjeni zgjidhje më të mira akoma! Organizoni një udhëtim: do të bëjë që të krijoni kontakte interesante me persona të panjohur.

GAFORJA

Për shkak të veprimit të Hënës, dita do të jetë disi e vështirë, me shumë kequmtime, anka dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmi. Asgjë për t'u shqetësuar, por dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

LUANI

Përsosmëria bëhet në venat e juaja, por do të ishte më mirë të lroheshit nga kjo, pasi ju streson dhe çon në ndikime negative në raportet profesionale. Takimi me dikë që nuk e keni parë prej shumë kohësh do të bëjë që të ndizet një flakë e vjetër pasioni.

VIRGJERESHA

Nëse ndiheni të kushëzuar nga kërkesat dhe gjykimet e një familjari, vërtini vetes objektivi që të lroheshit për të marrë vendime. Duke qenë se ju pëlqen të jeni në qendër të vëmendjes, do të zbuloni se kështu do të ndiheni mirë!

PESHORJA

Mbështetja e Mërkurit, por me armiqtësinë e Venusit dhe Marsit, do të bëjë që të ndiheni fajtor në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë. Nuk mund t'ia lëni më rastësisë.

AKREPI

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke ju vënë shkopin në rrotë. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rrit përkrah dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

SHIGJETARI

Për shkak të Venusit, çështje të zemrës mund të bëjnë që të lesh pas dore punën. Por Saturni ju tërheq vëmendjen dhe ju shtynë të keni përqendrim dhe gartësi në mendime. Nëse e kuptoni që personat që rinë rrethë rrotull jush nuk ju përshatën, largohuni prej tyre.

BRICJAPI

Të jeni më të dashur nuk ju bën veçse mirë. Padyshim, do të lehtësonte ndjeshëm raportet me personin që keni në krah. Mos e harro! Ndërrytja e një familjari në punët e juaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

UJORI

Jupiterit ju mbështet, nëse keni ndonjë ide të bukur që ju shkon ndërmend, vërtini në veprim. Do t'ia dilni të gjeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, largohuni duke e kaluar me sportivitet.

PESHQIT

Loja e dashurisë do t'ju shtyjë të gënjeheni disi, duke shpikur ëndrra dhe iluzione, por do t'ju shërbejë për të pasur një takim edhe më të mirë. Nganjëherë përpikimi të jini më të çirët, kur nuk i kuptoni nganjëherë gjërat nga kënavëstrimi i dikujt tjetër.

U desh balotazhi, presidenti në fuqi mori 38 vota ndaj 24 të rivalit të tij, Bashkim Fino

Duka fiton mandatin e pestë dhe përletet para Asamblesë

"Jam i lumtur, zgjedhje brenda standardeve"



Jeton Selimi

Asgjë nuk e rrëzon Armand Dukën! Presidenci aktual konfirmohet në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit, edhe për 4 vitet e ardhshme, duke fituar për herë të 5-të besimin e Asamblesë së Përgjithshme të këtij institucioni. Kreu aktual i FSHF-së arriti të marrë më shumë vota që në raundin e parë, 39, por jo aq sa duhej për të fituar direkt, duke bërë që për herë të parë në epokën Duka, të kemi nevojë për një raund të dytë votimesh. Në balotazh, Duka mori 38 vota, kundrejt 24 të rivalit të tij, Bashkim Fino, ndërsa 3 vota ishin të pavlefshme. Në këto zgjedhje, krahas Dukës kandiduan edhe Bashkim Fino e Shpëtim Hala, me këtë të fundit që u skualifikua që në raundin e parë, pasi nuk mori asnjë votë. Kjo ishte një nga betejat më interesante për kreun e Federatës Shqiptare të Futbollit, që kulmoi me debatin live të Dukës dhe Finos, në një studio televizive, ndërsa nuk munguan as akuzat e kundër-akuzat, por edhe tonet e larta. Gjithsesi, në përfundim të procesit zgjedhor, pavarësisht kontestimeve, kandidati Fino shtrëngoi duart me Dukën dhe e uroi për fitoren. Në fjalimin e tij, pas shpalljes së rezultatit, Duka u shpreh: "Jam i lumtur dhe emocionuar, jo për faktin se do jem presidenti, por për besueshmërinë dhe ndëj obligimin e madh se nga sot fillon një gjë akoma më e vështirë për mua. Asambleja u zhvillua brenda standardeve, dëshmon se ne jemi një organizatë me standarde të lartë brenda shoqërisë, ju garantoj të gjithëve se ato që janë diskutuar në këto muaj para zgjedhor do të jenë pjesë e diskutimit, do t'i korrigjojmë dhe do bëjmë më të mirën. Falënderoj shumë kandidatët, të ftuarit. Ju premtoj se përkushtimi im do të jetë akoma më i madh, më ka dhënë shumë mësim kjo Asamble".

Më tej në një prononcim për gazetaret në hollin e hotelit, presidenti Duka deklaroi: "Familja jonë është një standard tjetër. Zoti Fino e tha në fjalimin e tij, ku citoi Pelenë, se për të arritur një rezultat, duhet shumë punë dhe ne të gjitha i kemi arritur me punë. Emocionet e Europianit nuk mund t'i krahasoj aspak me këto të zgjedhjeve. Ato të Europianit ishin tejet të veçanta. Organizimi i Asamblesë ishte në një nivel shumë të lartë, dhe kjo u pa qartë. Unë jam president

RAUNDI I PARË	
39	vota Armand Duka
22	vota Bashkim Fino
0	vota Shpëtim Hala
4	vota të pavlefshme
RAUNDI I DYTË	
38	vota Armand Duka
24	vota Bashkim Fino
3	vota të pavlefshme

i sapo zgjedhur dhe mendoj për të realizuar jo vetëm ato që kam premtuar, por do mendoj si të ribashkoj të gjitha ato votat kundra që kisha në familjen e madhe."



ZGJEDHJET
Kjo ishte një nga betejat më interesante për kreun e Federatës Shqiptare të Futbollit, që kulmoi me debatin live të Dukës dhe Finos, në një studio televizive, ndërsa nuk munguan as akuzat e kundër-akuzat, por edhe tonet e larta. Gjithsesi, në përfundim të procesit zgjedhor, pavarësisht kontestimeve, kandidati Fino shtrëngoi duart me Dukën dhe e uroi për fitoren.

UEFA "BEKON" DUKËN Surkis: Zgjedhje të rregullta, Fino të ndihmojë si politikan

Mënjëherë pas përfundimit të votimit dhe fjalës përshëndetëse të presidentit të rizgjedhur, edhe zv.presidenti i UEFA-s, Surkis mbajti një fjalim për mediet, pak para largimit nga Asambleja. Ai vlerësoi kushtet në të cilat u zhvilluan zgjedhjet dhe bëri thirrje për më shumë punë drejt përmirësimit të nivelit të futbollit. "Zgjedhjet ishin brenda rregullave, të rregullta dhe në demokraci. Në mendimin tim nuk ka humbës. Është detyrë e Federatës që të zhvillojë futbollin. Kemi ide të reja se si do ta ndihmojë futbollin shqiptar. U bëra thirrje kandidatëve që të ndihmonin futbollin shqiptar. Dua që të uroj presidentin e Futbollit dhe t'i uroj sukseset. Fino mund ta ndihmojë futbollin nga pozita që ai ka."



rje për më shumë punë drejt përmirësimit të nivelit të futbollit. "Zgjedhjet ishin brenda rregullave, të rregullta dhe në demokraci. Në mendimin tim nuk ka humbës. Është detyrë e Federatës që të zhvillojë futbollin. Kemi ide të reja se si do ta ndihmojë futbollin shqiptar. U bëra thirrje kandidatëve që të ndihmonin futbollin shqiptar. Dua që të uroj presidentin e Futbollit dhe t'i uroj sukseset. Fino mund ta ndihmojë futbollin nga pozita që ai ka."

BATUTA Qarri për Dollanin: E mësoi penalltinë kjo?

Përgjatë raundit të dytë në zgjedhjet për president të FSHF-së ka ndodhur një episod me protagonistin presidentin e klubit të Kamzës dhe kryetares së Bashkisë Gramsh. Në momentin që kjo e fundit është ngritur për të votuar, presidenti i Kamzës ka bërë një batutë që ka shkakuar të qeshura në sallë "E mësoi penalltinë kjo?". Qarri i referohet videos së ditëve të fundit që qarkulloi në internet, ku aktori i humorit Bes Kallaku i ka bërë një shaka kryetares së bashkisë së Gramshit.

Arben Dervishaj: Është mandati im i fundit në KE 7 nga "garda e vjetër" dhe dy prurje të reja, ja Komiteti Ekzekutiv

Krahas konfirmimit të Armando Dukës në krye të FSHF-së, pasi mori shumicën e votave, Asambleja e Përgjithshme votoi edhe për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv pranë këtij institucioni. Nga numërimi i parë u arrit të zgjidhen vetëm 5 anëtarë, të cilët morën numrin e duhur të votave. Për të plotësuar numrin prej 9 anëtarësh në Komitetin Ekzekutiv, u zhvillua edhe një raund i dytë votimi, nga ku dolën dhe katër anëtarë të tjerë, prej të cilëve 7 janë pjesë e Komitetit të vjetër Ekzekutiv, ndërsa 2 të tjerët, janë "new entry", deputeti Enekelejd Alibeaj dhe ndërtuesi i stadiumit "Arena Kombëtare", Edmond Spahiu. "Votat janë njësoj, falë përkrahjes së presiden-

5 EMRAT E ZGJEDHUR NË RAUNDIN E PARË:	
Arben Dervishaj	42 vota
Abdyl Kuriu	40 vota
Bardhyl Jera	37 vota
Lutfi Nuri	34 vota
Vasil Bici	32 vota
4 EMRAT E ZGJEDHUR NË RAUNDIN E DYTË:	
Enkelejd Alibeaj	29 vota
Edvin Libohova	26 vota
Bardhyl Minxhozi	21 vota
Edmond Spahiu	18 vota

tit Duka. Ky është mandati i katërt. Unë shpresoj që të falënderoj anëtarësinë për besimin. Shpresoj se në këtë mandat të jap kontributin tim për të ecur akoma më tej. Besoj se është mandati im i fundit. Besoj se nuk ka nevojë për mua në Federatë,

do ketë nevojë për njerëz të rinj," deklaroi Arben Dervishaj. "Ishte një eksperiencë e mirë, pasi kur konkurron në një komunitet kaq të madh, ishte kënaqësi, pavarësisht pozicionit që dola. Eksperiencia e parë ka qenë e mirë, ndoshta edhe se



kishim risi, siç ishte pjesëmarrja në European. Ishte një motivim akoma dhe më i madh. Në këto katër vitet kam mbuluar teknikën, kemi bërë një punë të mirë për faktin se kemi pasur 9000 sportistë amator kanë zhvilluar kampionatet e veta, në

këto 9000 sportista kemi pasur 629 ekipe amatore. Kjo do të jetë zanafilla e punës time për mandatin e ri. Kam pasur fatin e madh që kam mbuluar teknikën, pasi e gjej veten më mirë se kudo," -u shpreh anëtari tjetër i rizgjedhur, Bardhyl Jera.

Fatos Tushe: Kur është bërë regjistrimi?

Pas fjalës së Surkis ka pasur debat në lidhje me shoqatat fantazmë, që FSHF pretendon se janë të rregullta. Kryebashkiaku i Lushnjës, Fatos Tushe, ka kërkuar shpjegime për shoqatat, duke theksuar se ato janë të paligjshme: "Me çfarë lloj vule është bërë delegimi? Duam përgjigje për 10 shoqatat", - ka thënë Tushe dhe më pas ka vazhduar ky debat:

Aldi Topçia: Informacioni nuk është 2, por është 10. Komisioni është autoriteti i vetëm i Asamblesë për të bërë verifikime. Asnjë autoritet tjetër nuk ka tagrin për ta kundërshtuar. Komisioni vlerëson se është mbledhur në mënyrë të

Debat për shoqatat fantazmë



rregullt dhe nuk ka arsye pse nuk duhet të vazhdojë rregullisht.

Fatos Tushe: Kemi bërë kërkesë edhe në FSHF që të

bëhemi të njohur me regjistrimet në gjykatë. Kemi njoftuar edhe UEFA-n. Kur janë regjistruar shoqatat?

Armand Duka:

Përgjigjen e dëgjuat nga juristi, Hajdari mund të japë informacion të detajuar.

Hajdari: Shqetësimi i Tushes është i drejtë, por nuk janë artikuluar si duhet. Shoqatat që ju thonë janë legjitimuar në 2012-ën. Çështja është substanciale dhe juridike e depozituar në gjykatë. I vetmi problem ishte depozitimi formal, lidhje me palë të treta, jo me Asamblenë. Asambleja e ka njohur dhe pranuar, kanë votuar. Komisioni e ka gjetur me vend edhe para këtij debati që kanë të drejtë në këtë asamble. Këto shoqata kanë vepruar, kanë pasur aktivitet, kanë votuar dhe nuk ka të drejtë askush t'ua heqë këtë të drejtë.

SITUATA

Duka do fitonte me 12 shoqatat "fantazmë"? Analiza e votave rrezon akuzën e Finos

Tashmë ka përfunduar gara për zgjedhjen e kreut të ri të FSHF-së dhe Armand Duka është rizgjedhur si president për herë të pestë. Rezultatet përfundimtare në raundin e dytë ishin: Duka 38 vota, Fino 24 vota dhe 3 të pavlefshme. Ndërsa, në raundin e parë Duka mori 39 vota dhe Fino 22 dhe 4 ishin të pavlefshme. Siç duket, Duka ka pësuar një rënie të vogël me vetëm një votë në raundin e dytë, ndërsa Fino ka fituar dy vota më shumë, por që lejohen vetëm për statistikë. Kandidati Fino tha në deklaratën pas humbjes se në këtë rezultat kanë ndikuar 12 shoqatat dhe në qoftë se ato nuk do të ishin, rezultati mund të ishte ndryshe. Por, sipas një kalkulimi të thjeshtë, Armand Duka mund të ishte shpallur president edhe pa votat e 12 shoqatave, kjo pasi edhe në qoftë se i heqim Dukës 12 vota, ai do të ishte shpallur fitues gjithsesi në raundin e dytë. Konkretisht, me një llogaritje të thjeshtë rezultati i raundit të dytë nga 38-24 në favor të Dukës do të ishte 26-24 po në favor të tij, gjë që e bën fitues Dukën sepse do të kishte 50%+1 vota.

Deputeti uron Armand Dukën, por premtori betejë në Tribunalin e Arbitrazhit Sportiv

Fino: Proces i pavlefshëm, çështjen e çoj në KAS

Kandidati humbës nuk njeh 12 shoqatat që votuan

Pas humbjes në raundin e dytë të Asamblesë për presidentin e Federatës së Futbollit, Bashkim Fino vijoi të kontestojë procesin. Sipas deputetit socialist, gara do të ishte e ndershme nëse nuk do të votonin 12 shoqatat sportive për të cilat nuk i ka fshehur pretendimet, si edhe disa klube, të cilat i etiketoi të përfshira në mënyrë të jashtëligjshme në zgjedhje. "Nuk jam i zhgënjyer. Unë e prisja diçka të tillë. Procesi që i parregullt në listat e delegatëve. Po të shikoni diferencën, janë ato që i kemi thënë gjatë gjithë këtij muaji. Ne do të vazhdojmë procesin tonë gjyqësor: Vendosja e disa ekipeve që nuk janë pjesë e futbollit dhe vendosa e delegatëve. Kam përshtypje që diferenca e pasqyroi këtë gjë. Po të mos ishin 12 shoqatat dhe këto 5-6 klube që janë vendosur në mënyrë ilegale, do të



ishite garë më e ndershme. Ju e patë që komisioni i verifikimit lexoi një raport që e kishte bërë gati FSHF-ja. Do ishte më e ndershme të kishte jurist të pavarur".

Pavarësisht se e uroi kandidatin Armand Duka për

mandatin e 5-të në krye të federatës, Fino bëri të ditur se do të vazhdojë betejën ligjore në gjykatat shqiptare, por edhe në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë dhe të FIFA. "Ne do e çojmë në fund çështjen, për të mirën

e futbollit. Ne do të respektojmë gjykatat shqiptare, më pas do të shkojmë jo vetëm në KAS, por edhe në FIFA. Në momentin që kundërshtuam 12 shoqatat, unë kam të drejtë të vazhdoj procesin ligjor. Unë i urova sukses Dukës.

I kam thënë dhe i kam dërguar UEFA-s të gjithë dokumentacionin e shoqatave. Futblli nuk fiton por humbet me një njeri në krye". Përsa i takon procesit, deputeti i mazhorancës u shpreh i bindur se gara mbeti vetëm në kuadrin sportiv, ndërsa dha një mesazh për anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv. "Varet si e kanë lexuar anëtarët e Asamblesë platformën. Koha ishte shumë e shkurtër për ta shpalosur tamam. Ata do vijnë në mendimet e mia. Gjysma e presidentëve në Europë janë deputetë apo politikanë. Për mua që një garë sportive. Anëtarët e interesuar për futbollin të jenë pjesë e komisionit. Ata janë aktorët kryesorë. Nuk mund të jenë një grup njerëzish që mund të marrin vota. U uroj anëtarëve të komitetit ekzekutiv të mësojnë kompetencat që kanë".

BATUTAT E PRESIDENTËVE



Gjici ngacmon Takajn: Po nuk të rrahu Vlora, do të të rrah unë!

Pas mbylljes së votimit për presidentin e ri të FSHF-së, tre nga presidentët e skuadrave pretendente për titull, Safet Gjici i Kukësit, Ardjan Takaj i Skënderbeut dhe Sinan Idrizi i Flamurtarit, bashkë me drejtuesin e të kuqve janë parë të diskutojnë mes tyre me humor. Një kafë dhe shumë batuta, ku në qendër të tyre kanë qenë penalltitë, ato që u mungojnë vlonjatëve dhe ato që fitojnë me lehtësi kuksianët dhe korçarët. "Po nuk të rrahu Vlora në Korçë, ja këtu do jemi", - i është drejtuar Gjici kolegut Takaj me humor. Me këtë grup është bashkuar edhe presidenti i Kamzës, Naim Qarri.

FUTBOLLI I LUAJTUR



Java e 19-të e Kategorisë Superiore do të nisë ditën e premtë, me atë që mund të cilësohet si supersfida e këtij raundi. Në stadiumin "Skënderbeu" të Korçës, skuadra e Ilir Dajës do të përballlet me Flamurtarin. Dueli mes vendit të parë dhe të dytë mund të përcaktojë shumë për sa i përket luftës për titull. Një fitore eventuale e bardhekuqeve do të përkthehet në një hap të sigurt drejt trofeut, ndërkohë që nëse të

Java e 19-të, edhe Partizani-Laçi do të luhet të shtunën

besuarit e Duros largohen me 3 pikë nga qyteti juglindor, atëherë rikthehet beteja. Kjo superndeshje do të zhvillohet të premtën, në orën 18:00. Raundi i 19-të do të plotësohet ditën e shtunë, kur do të luhet edhe 4 takimet e tjera. Në orën 14:00, Kukësi do të ketë një duel për të mos u nënvlerë-

suar, kundër Kamzës në "Zeqir Ymeri". Kampionët, pasi e rinisën sezonin me fitore, duket se kanë kryer një hap prapa, për shkak të dy barazimeve radhazi, në Kupë ndaj Tiranës dhe të dielën e shkuan kundër Flamurtarit. Në të njëjtën orë, Lushnja do të presë Vllazninë, në atë që mund të qu-

het duel për mbijetesën. "Lagunarët" për të mbajtur të gjalla shpresat, duhet të sigurojnë maksimumin e pikëve, ndërsa në krahun tjetër, kuqebluve nuk u falet më asnjë hap fals. Në orën 17:00, Teuta do të presë në "Niko Dovana" Luftëtarin. Durrsakët e kanë nisur vitin me 2 barazime, por kanë nevojë për pikë, që t'i largohen sa më shpejt zonës së rrezikut. Nga ana tjetër, Luftëtarin vjen pas një momenti mjaft të

mirë, pasi nuk humb prej 5 javësh në kampionat dhe do të kërkojë të ruajë formën e mirë. Partizani-Laçi, e programuar fillimisht për t'u luajtur të dielën në orën 17:00 është afruar me 24 orë, për shkak se po të dielën luan edhe Tirana në "Selman Stërmasi". Pasditën e të shtunës pritet një sfidë mjaft interesante në kryeqytet, mes dy skuadrave që synojnë të arrijnë zonën europiane nëpërmjet renditjes finale të Superiores.

Propozimi i BE-së, flet Presidenti i Kosovës: Qasje jo e drejtë për ne

'Washington Post': Strategjia e BE s'qartëson integrimin e Kosovës

Anëtarësimi i Kosovës, Thaçi: Ende i paqartë

Ditën e djeshme gazeta prestigjioze amerikane "Washington Post" në një artikull të botuar në versionin online, i ka kushtuar një shkrim Kosovës dhe përfshirjes së saj në strategjinë e re për zgjerim të Bashkimit Evropian. Në këtë artikull citohen deklaratat e krerëve shtetërorë të Kosovës, të cilët e cilësuan si diskriminim për Kosovën këtë strategji, dhe e cila nuk mori për bazë sukseset e arritura nga shteti më i ri në Evropë. Ky artikull vazhdon me faktin se Bashkimi Evropian të martën u bëri thirrje shteteve të Ballkanit që të zgjidhin çështjet e kufirit përpara anëtarësimit në Bllok. Aty citohet edhe fakti që Kosova do të përfitojë nga kjo strategji vetëm nga normalizimi përfundimtar i raporteve me Serbinë. "Kosova kishte shpallur pavarësinë nga Serbia më 2008, edhe pse kjo e fundit nuk e ka njohur si shtet Kosovën", përmendet në këtë artikull. Ndërkohë që nga ana tjetër ka reaguar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Një ditë pasi Komisioni Evropian publikoi strategjinë e re për perspektivën e integritimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Ai thotë se duhet ratifikuar marrëveshja për vijën kufitare me Malin e Zi, e cila sjell edhe heqjen e vizave për qytetarët. "Komisioni Evropian publikoi dje strategjinë e re për perspektivën e integritimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Këtë strategji e vlerësoj si një përpjekje të BE-së për të rritur përkushtimin dhe nxitur reformat e shteteve të rajonit për anëtarësim në BE. Prandaj, e mirëpres hartimin e këtij dokumenti strategjik, i cili e trajton Kosovën si pjesë integrale të planeve për zgjerim të Bashkimit Evropian. Megjithatë, për arsye të njohura politike, fatkeqsisht, ky dokument nuk ka arritur të paraqes një perspektivë të anëtarësimit gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjitha vendet e rajonit. Në veçanti, kjo strategji ka dështuar të ofrojë qartësi për anëtarësimin e Kosovës në BE. Kjo qasje jo e drejtë ndaj Kosovës është pasojë e mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, respektivisht e paaftësisë së BE-së për një qëndrim unik për Kosovën. Por, Kosova nuk do të zhytet në dëshpërim. Ne duhet ta shfrytëzojmë potencialin e plotë të kësaj strategjie për të avancuar pozicionin tonë në rrugën drejt anëtarësimit, për zbatimin e reformave të nevojshme evropiane dhe për të përmbyllur procesin e dialogut me Serbinë të ndërmjetësuar nga BE-ja", ka shkruar ndër të tjera në statusin e tij presidenti Thaçi.



"WASHINGTON POST"
Në artikullin e "Washington Post" citohet edhe fakti që Kosova do të përfitojë nga kjo strategji vetëm nga normalizimi përfundimtar i raporteve me Serbinë. "Kosova ka shpallur pavarësinë nga Serbia më 2008, edhe pse kjo e fundit nuk e ka njohur si shtet Kosovën", shkruhet aty.



Politikani serb: Vrasja e Oliver Ivanoviçit

s'do të zbardhet kurrë
Ksenija Bozović, nënkryetari i Iniciativës Qytetare, SDP, ka thënë se vrasja e ish-liderit të saj, Oliver Ivanoviç, nuk do të zbardhet kurrë. Ai ka thënë se vrasësit e tij nuk do të kapen asnjëherë, raporton media serbe "Tanjug". Sipas Bozović, hetimet për këtë rast janë duke u zhvilluar në mënyrën e gabuar që nga fillimi i tyre. Ndërkohë që Oliver Ivanoviç, lideri i iniciativës Qytetare "Serbia, Demokracia dhe Drejtësia" është vrarë në mëngjesin e 16 janarit të këtij viti, para zyrave të partisë së vet në Mitrovicën e Veriut. Vrasjen e tij janë duke e hetuar institucionet kosovare të drejtësisë.

Përfaqësuesja e Bashkimit Evropian: Brukseli s'do diktojë asgjë

Anëtarësimi në BE, Mogherini: Kosova dhe Serbia do arrijnë marrëveshje në 2019

Federica Mogherini, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian, ka komentuar Strategjinë e Zgjerimit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor: Ajo është shprehur optimiste se Serbia do të bëhet anëtare e BE-së deri në vitin 2025, ashtu siç është parathënë edhe më parë nga vetë projekti i paraqitur nga BE, por sipas saj kjo do të arrihet duke zbatuar kushtet që janë vendosur. Duke folur për dialogun Kosovë-Serbi, Mogherini ka thënë se pret që marrëveshja



Federica Mogherini

dozmëri nga Beogradi dhe Prishtina për të diskutuar normalizimin gjithëpërfshirës, me shpresë që do të reflektohet në një marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Unë besoj që një marrëveshje mund të arrihet deri në fund të vitit 2019", ka thënë Federica Mogherini për RTS. E pyetur se cila do të jetë përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, shefja e diplomacisë së BE-së deklaroi se aktualisht nuk po mendon këtë pjesë. "Unë


nuk mendoj për këtë. Nuk dua të flas për atë se çfarë dy palët do të ishin të kënaqura. Do të vijë koha edhe për këtë. Brukseli nuk do të diktojë asgjë, vetëm do të mbështesë dhe ndihmojë", ka theksuar Federica Mogherini. Ndërkohë që nga ana tjetër, në bazë të Strategjisë së Zgjerimit të BE-së, dialogu Kosovë-Serbi është faktori kryesor në rrugën e dy vendeve për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian.




"Policia e Kosovës e di kush e vrau Oliver Ivanoviçin"

Janë zbuluar të tjera detaje të sakta lidhur me vrasjen e kreut të SDP, Oliver Ivanoviç. Institucionet e sigurisë së Kosovës, ka mësuar gazeta "Express", kanë informata të mjaftueshme për rastin e vrasjes së politikantit serb në Veri të Kosovës. "Edhe AKI, por edhe policia e Kosovës, kanë informata për dorasin dhe për motivet e vrasjes së Oliver Ivanoviçit", - ka thënë një burim i mirinformuar. "Ndoshta edhe më tutje këto informata nuk janë ato të duhurat, sa për të kryer arrestimin, mirëpo pista ekziston. Ekziston rreziku që, nëse arrestimet do të kryeshin tash, do të mund të dëmtoheshin hetimet e mëvonshme". "Për këtë gjë, këto institucione, pra këto të sigurisë, i kanë informuar edhe udhëheqësit politikë, sipas të gjitha gjasave edhe në Kosovë, por edhe në Serbi", - ka thënë ky burim.

HASHIM THAÇI
KE publikoi strategjinë e re për perspektivën e integritimit të Ballkanit Perëndimor në BE. Këtë strategji e vlerësoj si një përpjekje të BE-së për të rritur përkushtimin dhe nxitur reformat e shteteve të rajonit për anëtarësim në BE. Prandaj, e mirëpres hartimin e këtij dokumenti strategjik, i cili e trajton Kosovën si pjesë integrale të planeve për zgjerim të Bashkimit Evropian.




"WASHINGTON POST"
Kosova ka shpallur pavarësinë nga Serbia më 2008, edhe pse kjo e fundit nuk e ka njohur si shtet Kosovën. Kjo e fundit do të përfitojë nga kjo strategji e nxjerrë nga Bashkimi Evropian vetëm nga normalizimi përfundimtar i raporteve me Serbinë. Ndërkohë që Bashkimi Evropian të martën u bëri thirrje shteteve të Ballkanit që të zgjidhin çështjet e kufirit përpara anëtarësimit në bllok.



hjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, respektivisht e paaftësisë së BE-së për një qëndrim unik për Kosovën. Por, Kosova nuk do të zhytet në dëshpërim. Ne duhet ta shfrytëzojmë potencialin e plotë të kësaj strategjie për të avancuar pozicionin tonë në rrugën drejt anëtarësimit, për zbatimin e reformave të nevojshme evropiane dhe për të përmbyllur procesin e dialogut me Serbinë të ndërmjetësuar nga BE-ja", ka shkruar ndër të tjera në statusin e tij presidenti Thaçi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementare.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legendat.


38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.

18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshqijellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)



HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapazonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me të bëjnë triko.
49. Një guajtje fututrimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e reziqshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.

8. Gjysmë shtegu.
9. Hidden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllin me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		8	9					7	
5			7	4	8				1
1		6	3				9		8
	4					9	8		
2		3						5	4
		7	5						6
7		1			6	2			3
3			8	2	5				9
	5				3	4			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	3	1	6	4	8	2	5	9
6	8	2	3	9	5	7	1	4
9	5	4	7	2	1	6	3	8
5	4	9	8	3	7	1	6	2
3	6	7	2	1	9	4	8	5
2	1	8	5	6	4	9	7	3
4	9	6	1	5	3	8	2	7
1	7	3	4	8	2	5	9	6
8	2	5	9	7	6	3	4	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "Përpara se të nisesh për hakmarrje, gërmo dy varre".
Konfuciu
- "Të fuqishëm nuk janë ata që gjithmonë fitojnë, por ata që pavarësisht se sa herë dështojnë, kurrë nuk reshtin së përpjekuri".
Liam Prynë
- "Kij parasysh se vetëm ai që lufton me errësirën brenda tij, do të ketë nesër e pasnesër një pjesë të tij tek Dielli".
Odisea Eliti

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

K	S	U	L	T	14	4	9	7	4	19		
8	10	5	1	4	12	2	6	7	5	10		
10	4	7	4	1	2	8	10	6	4	7	5	
18			1	7	5	8	9	4	2	10	4	
6	5	1	6	2	10	5	2	5		12		
7	1		17	5		1	5	10	17	4	2	
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	
8	2	8	12		15		6	10	17	5		
18	10	5	16	19		6	4	8	10	1	1	
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8

D	A		L	Q	E	N	T	E			
Q	E	L	Q	T	I	M		E	L		
A	H	E	K	U	R	U	D	H	O	R	E
R	L	P	E	L	I	K	A	N	I	M	
K	H	E	L	I	K	O	P	T	E	R	E
M	N	T	P	Z		O	N				
Q	U	I	E	A	A	L	E	D	T		
I	Z	A		N	O	T	I	M	I		
L	I	T	A	R	E	T	S	I	T	A	
I	K	O	N	A	T	K	A	L	A	M	A
M	A	M	S	A	N	T	I	K	T		
I	I	R	O	N	I	K	O	A	Z	I	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

K	O	P	E	R	T	I	N	A	T	E	B	A
O	M	A	R	K	N	L	A	T	O	M		
L	A	L	O	S	D	E	B	I	M	E	T	
L	A	S	H	P	R	I	P	A	R	I	M	
A	L	S	K	O	L	O	N	E	T	M	A	
P	A	R	A	Z	I	T	E	O	D	E	T	
E	M	I	R	A	T	I	U	R	A	T	E	
G	I	P	A	K	A	T	I					
A	S	M	A	U	R	E	N	T	E	I		
B	A	Z	A	T	E	D	P	E	M	A		
I	T	R	A	N	A	T	L	E	I	K	I	L
M	T	R	I	A	M	A	T	A	M	A	N	E

P	A	P	A	R	A	Z	Z	O	T	H	I	
A	N	E	T	A	R	P	A	G	E	S	A	T
P	A	R	M	A	K	N	O	T	A	R	E	
A	T	L	S	A	H	G	A	R	A	T	E	
S	E	A	K	A	T	E	G	O	R	I	K	E
M	K	A	P	I	T	A	L	I	I			
M	A	N	I	P	U	L	I	M	E	A	R	O
A	N	T	L	O	N	M	E	T	A	L	I	K
S	E	T	I	M	E	S	R	T	L	T		
K	A	M	P	E	R	E	T	A	P	E		
A	R	I	E	B	A	L	E	R	I	N	A	T
T	A	L	L	J	A	E	R	A				

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Shenjtorët janë mëkatarët që vazhdojnë të përpiqen gjithnjë.
(Robert Luis Stivenson)
- Një njeri i zgjuar përfiton më shumë nga armiqtë, se sa një budalla nga miqtë.
(Baltazar Graciani)
- Në këtë botë të gjithë do vdesim. Kujto, si mund të mbash armiqtësi?
- Në këtë botë urrejtja nuk mund t'i japi fund urrejtjes. Vetëm dashuria është e aftë ta shuajë atë. Ky është Ligji i Përfjetshëm.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

